

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

01 Nr.No.Br. 052-9689/26

Data-Data: 12.07.2026

Klinë-Klina



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org



RAPORTI I PUNËS I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2025

Klinë, shkurt 2026



FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetarë,

Kam kënaqësinë që sot t'ju paraqes raportin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025, raport ky që pasqyron në mënyrë të përmbledhur dhe transparente punën njëvjeçare të komunës, arritjet kryesore, projektet e realizuara si dhe aktivitetet e zhvilluara në shërbim të qytetarëve.

Viti 2025 ka qenë një vit i angazhimit të vazhdueshëm dhe i realizimit të një numri të konsiderueshëm projektesh të dobishme dhe të domosdoshme për komunitetin tonë. Gjatë këtij viti janë zbatuar synimet dhe objektivat e planifikuara, në përputhje me planin e punës, strategjinë zhvillimore të komunës dhe aktet ligjore në fuqi.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, si dhe të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit me qytetarët, gjatë vitit 2025 kam mbajtur dy takime publike me qytetarë, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Po ashtu, Komuna ka organizuar dëgjime buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe për buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2025, duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor.

PËRMBAJTJA

Fjala e kryetarit.....	2
1. Drejtoria e Administratës.....	4
2. Drejtoria e Arsimit.....	12
3. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.....	19
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....	23
5. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	30
6. Drejtoria e Inspektoratit.....	33
7. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	38
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	50
9. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	61
10. Drejtoria e Financave, Ekonomisë Dhe Zhvillimit.....	67

1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Raporti vjetor i punës për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2025, i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare të Drejtorisë së Administratës, si dhe vështirësitë me të cilat jemi përballur gjatë vitit 2025.

Me gjithë vështirësitë, me angazhim është arritur të realizohen synimet dhe objektivat e parapara sipas ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të Administratës Komunale, me qëllim që të arrihen objektivat e parapara në Planin e Punës, për krijimin e kushteve sa më të mira për qytetarët e kësaj Komune.

Administrata Komunale gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale për qytetarët, në riorganizimin profesional dhe reformimin në kuadër të reformës së administratës publike, në punën transparente me media, OJQ dhe shoqërinë civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare dhe duke demonstruar qeverisje transparente, komunikim dhe qasje të hapur ndaj qytetarëve.

Gjatë vitit 2025, Komuna ka pasur për qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- Administratë publike në shërbim të qytetarëve;
- Hapje e Komunës për qytetarët;
- E drejta për t'u informuar, e cila është e drejtë e garantuar me ligj dhe që në Komunën e Klinës zbatohet dhe respektohet;
- Kthimi i besimit të qytetarëve në institucionet publike përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbimet komunale;
- Qytetarët të bëhen pjesë aktive e vendimmarrjes së Komunës;
- Klina si platformë digjitale për pjesëmarrje me publikun;
- Lajmërimi nga qytetarët për parregullsi në çdo kohë dhe në çdo vend;
- Qasja në dokumentet zyrtare.

Prandaj, në pajtim të plotë me Planin e Veprimit për vitin 2025, besojmë se të gjitha obligimet që dalin nga këto plane dhe në përputhshmëri të plotë me ligjet aplikative në fuqi do t'i përmbushim edhe në vitin 2026.

Drejtorja e Administratës për vitin 2025 ka realizuar punët sipas Planit të Punës së Drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarë nga të gjitha zyrat me të cilat administrojnë. Punët e kryera janë si në vijim:

1. SEKTORI I GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIMIT

Nga Sektori i Gjendjes Civile dhe Regjistrimit, në periudhën raportuese janar–dhjetor 2025, janë bërë:

- Regjistrime të lindjes: 424
- Regjistrime të martesës: 440

- Regjistrime të vdekjes: 261
- Certifikata të lëshuara: 37.095
- Taksa të inkasuara: 38.760,00 €
- Aplikacione për humbje të shtetësisë: 150
- Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm, ndërrim të emrit dhe mbiemrit, korrigjime: 144

Nga E-Kioska janë kryer këto shërbime:

- Certifikata të lëshuara: 1.586
- Taksa të inkasuara: 1.586,00 €

Janë inkasuar gjithsej taksa administrative nga Sektori i Gjendjes Civile në vlerë prej 42.006,00 €.

Projektet kapitale të përfunduara gjatë vitit 2025

- Ndërtimi dhe rinovimi i objektit të Komunës.

2.SHËRBIMI PËR PUNË TË KUVENDIT

Shërbimi për Punë të Kuvendit gjatë vitit 2025 ka përgatitur materialin për:

- 8 seanca të rregullta;
- 3 seanca solemne;
- 1 seancë inauguruese.

Debate me publikun janë mbajtur 2. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë miratuar 2 rregullore dhe gjithsej 55 akte.

Janë shqyrtuar raporti vjetor i punës së ekzekutivit, i Kuvendit dhe i komiteteve të Kuvendit, raporti i prokurimit, si dhe raporti i Auditorit të Jashtëm së bashku me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit. Janë miratuar vendime dhe rregullore të Kuvendit Komunal, janë shqyrtuar dhe miratuar raporte financiare, ndërsa të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë brenda afatit të caktuar në MAPL.

Takimet e komiteteve:

- Komiteti për Politikë dhe Financa: 10 takime
- Komiteti për Komunitete: 8 takime
- Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport: 0 takime
- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: 0 takime
- Komiteti për Shërbime Publike: 0 takime
- Komiteti për Pronë: 0 takime

- Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim: 0 takime

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur 6 takime. Takime me qytetarët: Kryetari ka mbajtur 2 takime dhe një takim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.

3. ZYRA PRITËSE-ARKIVA

Nga Zyra Pritëse, gjatë vitit 2025 janë regjistruar, skanuar dhe evidentuar në librin intern sipas drejtorive:

1. Drejtoria e Administratës – 1.244 lëndë
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – 93 lëndë
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – 772 lëndë
4. Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi – 498 lëndë
5. Drejtoria për Financa – 781 lëndë
6. Drejtoria e Arsimit – 1.740 lëndë
7. Drejtoria e Bujqësisë – 2.711 lëndë
8. Drejtoria e Shërbimeve Publike – 496 lëndë
9. Drejtoria e Urbanizmit – 1.079 lëndë
10. Drejtoria e Inspektorëve – 238 lëndë
11. Shërbimi i Kuvendit – 202 lëndë
12. Presidenca – 2.356 lëndë
13. Zyra e Prokurimit – 285 lëndë
14. Zyra për Kthim dhe Komunitete – 45 lëndë

Totali i lëndëve të regjistruara për vitin 2025 është: 12.537 lëndë.

Nga ky sektor, përveç regjistrimeve, janë regjistruar dhe vërtetuar përkrahje dhe dorëshkrime, si dhe kërkesa të palëve. Gjithashtu janë lëshuar vërtetime, deklarata etj., sipas kërkesave të klientëve. Në Librin e Postës janë regjistruar dërgesa të dorëzuara në PTK – Klinë. Në regjistrin e postës në vend janë regjistruar shkresa të dala nga KK, të cilat janë shpërndarë në terren dhe te gazetatat zyrtare.

4. ZYRA E INFORMIMIT

Ky raport pasqyron punën dhe aktivitetet e Zyrës për Informim të Komunës së Klinës gjatë vitit raportues, me qëllim dokumentimin e angazhimit institucional në informimin e qytetarëve, sigurimin e transparencës komunale, trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe publikimin e akteve komunale në Gazetën Zyrtare.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Informim ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet komunale, duke ushtruar këto detyra kryesore:

- Informimin e qytetarëve për vendimet, aktivitetet dhe projektet e Komunës;
- Komunikimin zyrtar me media dhe publikun;

- Përgatitjen dhe publikimin e informatave dhe njoftimeve komunale;
- Trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike;
- Koordinimin e publikimit të akteve komunale në Gazetën Zyrtare;
- Mbështetjen e transparencës dhe llogaridhënies komunale.

Në kuadër të zbatimit të këtyre detyrave, gjatë vitit raportues janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Janë publikuar në mënyrë të rregullt informata dhe njoftime lidhur me vendimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal dhe drejtorive komunale;
- Janë informuar qytetarët për projektet kapitale, shërbimet komunale dhe aktivitetet zyrtare;
- Është siguruar koordinim i vazhdueshëm me drejtoritë komunale për ofrimin e informatave të sakta dhe në kohë;
- Janë trajtuar kërkesat dhe interesimet e qytetarëve dhe mediave në mënyrë profesionale.

Publikimi i informatave zyrtare është realizuar kryesisht përmes uebfaqes zyrtare të Komunës së Klinës (<https://kk.rks-gov.net/kline/lajmet/>), e cila ka shërbyer si kanali kryesor i komunikimit zyrtar me publikun. Uebfaqja është mirëmbajtur dhe përditësuar rregullisht, duke ofruar informata të besueshme dhe të qasshme për qytetarët dhe palët e interesuara.

Gjatë vitit raportues, kërkesat për qasje në dokumente publike janë trajtuar në përputhje të plotë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, në mënyrë transparente dhe brenda afateve ligjore.

Po ashtu, Zyra për Informim ka kryer detyrat që lidhen me publikimin e akteve komunale në Gazetën Zyrtare, përfshirë përgatitjen, verifikimin dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse për publikimin e vendimeve, rregulloreve dhe akteve komunale.

Zyra për Informim ka mbajtur bashkëpunim të rregullt dhe korrekt me media lokale dhe qendrore, duke siguruar komunikim transparent, qasje të barabartë në informata dhe përgjigje në kohë ndaj kërkesave mediatike.

Në përfundim, gjatë vitit raportues, Zyra për Informim e Komunës së Klinës ka përmbushur me përgjegjësi detyrat e saj ligjore dhe institucionale, duke kontribuar në rritjen e transparencës komunale, informimin e drejtë dhe në kohë të qytetarëve, si dhe në forcimin e besimit ndaj institucionit komunal.

5. NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZBGJ-rë

Zyrtarja për Barazi Gjinore ka përmbledhur punën e saj për vitin 2025, gjatë të cilit ka realizuar një sërë aktivitetesh të planifikuara në kuadër të Planit të Veprimit Lokal për Barazi Gjinore 2024–2026. Synimi i këtij plani ishte promovimi dhe zbatimi i parimeve të barazisë dhe drejtësisë gjinore në të gjitha fushat e jetës publike dhe institucionale në nivel komunal.

Gjatë këtij viti, është punuar në ngritjen e kapaciteteve të grave në fusha të ndryshme përmes debateve, fushatave sensibilizuese, aktiviteteve sportive promovuese (p.sh. e drejta në trashëgimi dhe pronë), rekomandimeve, punëtorive dhe bashkëpunimeve ndërkomunale, si dhe në nivel qendror dhe rajonal.

Në kuadër të debateve janë trajtuar tema të ndryshme, duke përfshirë: barazinë gjinore në familje, shkollë dhe shoqëri; të drejtat në marrëdhëniet e punës; integrimin gjinor; komunikimin menaxherial; ngacmimet seksuale; shëndetin dhe mirëqenien; pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse; pozitën aktuale të grave në këto procese; edukimin për feminizmin; sensibilizimin e grave për përfitimet nga programet bujqësore; dhunën në familje; mbrojtjen nga trafikimi dhe diskriminimi; dhe tema të tjera relevante.

Aktivitetet gjatë vitit 2025

- **21.01.2025** – Në bashkëpunim me organizatën Integra, u organizua një takim për gratë dhe vajzat e Komunës së Klinës me temën “Gatimet tradicionale dhe shkëmbimi i përvojave”. Gjatë këtij takimi u promovuan produktet e grave pjesëmarrëse. Në aktivitet morën pjesë 13 gra dhe vajza me biznese të vogla familjare në fushën e blegtorisë dhe përgatitjes së ushqimeve tradicionale.
- **27.02.2025** – Zyrtarja për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me Qendrën e Sigurt në Pejë, organizoi një trajnim me temën “Bashkëpunimi ndër-etnik”. Komuna e Klinës njihet si një komunë shumetnike dhe shembull i marrëdhënieve të mira ndër-etnike. Në këtë kontekst u theksua edhe roli i Zyrës për Komunitete, e cila merret me rikthimin dhe riatdhesimin e personave.
- **08.03.2025** – Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Zyrtarja për Barazi Gjinore organizoi aktivitete informuese për promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave, të drejtat e tyre dhe sfidat me të cilat përballen. Në aktivitet mori pjesë një numër i konsiderueshëm i grave dhe vajzave të Komunës së Klinës.
- **28.04.2025** – Me mbështetjen e UN Women Kosovë dhe në kuadër të projektit “Gender Equality Facility (GEF)”, i financuar nga Bashkimi Evropian, u organizua trajnimi me temën “Buxheti i përgjegjshëm gjinor si mjet për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028”. Qëllimi i trajnimit ishte forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve komunalë.
- **22.05.2025** – Në kuadër të projektit “Monitorimi dhe llogaridhënia me ndjeshmëri gjinore”, i zbatuar nga Qendra Kosovare e Studimeve Gjinore dhe i financuar nga Bashkimi Evropian përmes UN Women, u mbajt një panel diskutimi me temën “Promovimi dhe zbatimi i barazisë gjinore”. Paneli shërbeu si platformë për shkëmbimin e ideve dhe rekomandimeve për integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike.
- **16.07.2025** – Zyrtarja për Barazi Gjinore organizoi një trajnim me temën “Fuqizimi i grave në vendimmarrjen lokale”, në partneritet me UN Women dhe me mbështetje nga projekti GEF. Trajnimi kishte për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe institucionet publike.

Aktivitetet sensibilizuese

Tetori – Muaji Rozë

Në bashkëpunim me QKMF-në janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuere për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Gjatë muajit tetor janë realizuar ekzaminime dhe mamografi pa pagesë për qytetaret.

Nëntori – 25 Nëntor

Në kuadër të shënimit të **16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore**, janë organizuar aktivitete sensibilizuese në bashkëpunim me institucionet publike dhe shoqërinë civile. Janë shpërndarë fletëpalosje informuese lidhur me format e mbrojtjes së grave nga dhuna. Gjatë vitit 2025, zyrtarja ka qenë e angazhuar në shumë aktivitete, punëtori dhe tryeza diskutimi, në koordinim me ABGJ-në, drejtoritë komunale, shoqërinë civile dhe organizatat joqeveritare.

6.ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Gjatë vitit 2025 janë kryer punët si në vijim: është përkrahur stafi i Administratës Komunale të Komunës së Klinës në aspektin e teknologjisë informative, duke përfshirë intervenime në pajisjet e TI-së, si kompjuterë, printerë, monitorë dhe pajisje të tjera periferike, me qëllim të mbarëvajtjes normale të punës dhe rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Shërbimi i IT-së ka bërë instalimin e kompjuterëve të rinj të blerë gjatë vitit 2025, duke instaluar softuerët e nevojshëm dhe konfigurimet përkatëse, në përputhje me udhëzimet administrative dhe legjisllacionin në fuqi. Po ashtu, aty ku ka qenë e nevojshme, janë bartur shërbimet nga pajisjet e vjetra në pajisjet e reja. Në këtë aspekt, konsiderohet se Komuna e Klinës ka nevojë për ngritje të mëtejme të kapaciteteve të pajisjeve të IT-së.

Janë krijuar të gjitha llogaritë për stafin e ri të Komunës së Klinës, ndërsa, me kërkesë të personelit, janë pasivizuar llogaritë e zyrtarëve që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës ose janë pensionuar. Gjatë këtij viti është ofruar përkrahje teknike për zyrtarin përgjegjës për E-Kioskën, sa herë që ka qenë e nevojshme. Serverët **Windows Server** që funksionojnë në Komunën e Klinës janë përditësuar (update) sipas rekomandimeve të ASHI-së dhe prodhuesit.

Po ashtu, gjatë këtij viti është ofruar përkrahje teknike për Zyrat e Gjendjes Civile në terren, përmes intervenimeve në distancë dhe, sipas nevojës, edhe përmes intervenimeve lokale, me qëllim të funksionalitetit të plotë të zyrave, si në aspektin e lidhjeve VPN, ashtu edhe të pajisjeve si kompjuterë, monitorë, printerë, fotokopjues dhe skanerë.

Gjithashtu, është përgatitur salla e Kuvendit Komunal për seancat e rregullta në aspektin e teknologjisë informative, si dhe janë kryer edhe punë të tjera sipas kërkesës së eprorit, që ndërlidhen me fushën e teknologjisë informative.

7. ZYRA E PRANIMIT TË MALLIT

Nga ky sektor është kryer puna e pranimi të mallit, duke evidentuar të gjitha hyrjet dhe daljet e materialeve shpenzuese, kompjuterëve, printerëve, fotokopjuesve dhe materialeve të tjera shpenzuese. Gjithashtu, janë përgatitur edhe raportet e pagesave në sistemin **FreeBalance**.

8. ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2025, kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- Konkurse – Administratë (procedura): **19**
- Konkurse – Arsim: **28**
- Konkurse – Shëndetësi: **8**
- Ankesa në KPMSHCK: **45**
- Përgjigje në ankesa të KPMSHCK-së: **45**
- Vendime për pushime vjetore: **250**
- Janë miratuar gjithsej: **2.711 lëndë**
- Vendime për ndërprerje të punës (pensionim): **22**
- Trajnime të zhvilluara: **17**
- Vendime për pushime të lehonisë: **3**
- Aktemërimet për të gjithë shërbyesit civilë: **120**

Në vazhdimësi është realizuar digjitalizimi i dosjeve personale të nëpunësve. Të gjitha konkursat e shpallura nga Drejtoria e Arsimit dhe Shëndetësisë janë përgatitur dhe publikuar në HRMS. Gjithashtu, Drejtoria ka marrë pjesë në trajnimet e Forumit të Menaxherëve në nivel vendi.

9. SEKTORI TEKNIK – LOGJISTIKA

Nga ky sektor, gjatë vitit 2025 janë kryer me sukses këto punë: ruajtja e objektit të Komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organet dhe palët, si dhe kryerja e punëve të tjera sipas nevojës.

10. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjendja e sigurisë gjatë vitit 2025

Sa i përket gjendjes së sigurisë gjatë periudhës **janar–dhjetor 2025** në Komunën e Klinës, lëvizja e qytetarëve ka qenë e lirë dhe në nivel të kënaqshëm. Nuk ka pasur asnjë eksces në lëvizjen e lirë të komuniteteve pakicë në Komunën e Klinës.

Përveç kësaj, Zyra ka kryer punët e saj të përditshme në terren, përfshirë përcjelljen e gjendjes dhe nevojave të personave të kthyer, si dhe realizimin e punëve administrative brenda Zyrës.

2. DREJTORIA E ARSIMIT

Investimet Kapitale

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Arsimit ka realizuar një sërë investimesh kapitale me rëndësi të veçantë, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe në krijimin e kushteve më të sigurta, funksionale dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Këto investime janë realizuar në përputhje me planifikimin buxhetor dhe nevojat reale të institucioneve arsimore në territorin e Komunës së Klinës.

Buxheti i planifikuar për investime kapitale gjatë vitit 2025 ka qenë 230,000.00 euro, nga i cili janë realizuar shpenzime në nivel 78.72%, duke reflektuar një zbatim të qëndrueshëm të projekteve të planifikuara dhe një menaxhim të kujdesshëm të mjeteve financiare. Pjesa e realizuar e këtij buxheti ka qenë e orientuar drejtë projekteve prioritare që kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve fizike të shkollave dhe në rritjen e cilësisë së ambientit mësimor për nxënësit dhe mësuesit.

Ndërtimi i fushës sportive në Sferkë

Një nga projektet më të rëndësishme kapitale gjatë vitit 2025 ka qenë ndërtimi i fushës sportive në fshatin Sferkë. Ky projekt, me vlerë totale prej 34,111.00 euro, përfaqëson një investim strategjik në promovimin e aktiviteteve fizike, sportit shkollore dhe një stili jetese të shëndetshëm për nxënësit dhe të rinjtë e kësaj zone.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar pagesa në vlerë prej 20,000.00 euro, ndërsa pjesa e mbetur e projektit është planifikuar të përfundojë në fazat e ardhshme. Përmes këtij investimi, nxënësve u ofrohet një hapësirë e dedikuar për aktivitete sportive dhe rekreative, duke kontribuar në zhvillimin e tyre fizik, social dhe edukativ.

Instalimi i pompave me pelet dhe rritja e efikasitetit energjetik

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të ngrohjes në shkolla dhe rritjes së efikasitetit energjetik, gjatë vitit 2025 janë realizuar investime të rëndësishme në instalimin e pompave me pelet në disa institucione arsimore.

Në Gjimnazin “Luigj Gurakuqi” projekti është realizuar me vlerë 16,000.00 euro dhe është përfunduar me sukses, duke siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe ekonomik të ngrohjes. Ky investim ka ndikuar në krijimin e kushteve më të mira për qëndrimin e nxënësve dhe stafit arsimor gjatë sezonit dimëror.

Në shkollën e Budisalcit, projekti ka pasur një vlerë totale prej 22,627.15 euro, me një zbritje prej 800.00 euro, ndërsa realizimi i tij ka kontribuar ndjeshëm në uljen e kostove operative dhe përmirësimin e komoditetit në ambientet shkollore.

Ndërsa në shkollën e Grabanicës, investimi ka pasur vlerë totale prej 13,324.00 euro, nga të cilat gjatë vitit 2025 janë paguar 12,865.00 euro. Edhe ky projekt ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit energjetik dhe në sigurimin e kushteve më të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.

Ndikimi i investimeve kapitale

Investimet e realizuara gjatë vitit 2025 kanë pasur ndikim pozitiv në disa aspekte kyçe, përfshirë:

- përmirësimin e infrastrukturës shkollore;
- krijimin e ambientit më të sigurt dhe më funksional për nxënësit dhe stafin arsimor;
- uljen e shpenzimeve të energjisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare;
- promovimin e aktiviteteve sportive dhe shëndetit të nxënësve.

Këto ndërhyrje përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve në institucionet arsimore të Komunës së Klinës.

Furnizimet me Mallra dhe Shërbime

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Arsimit ka realizuar shpenzime të konsiderueshme në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, me qëllim të përmirësimit të sigurisë, funksionalitetit, mirëmbajtjes dhe estetikës së institucioneve arsimore në Komunën e Klinës. Këto ndërhyrje kanë qenë të domosdoshme për garantimin e një mjedisi të qëndrueshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Buxheti i planifikuar për mallra dhe shërbime gjatë vitit 2025 ka qenë 477,026.80 euro, nga i cili janë realizuar shpenzime në nivel 92.55%. Kjo përqindje e lartë e realizimit dëshmon për nevojat reale të institucioneve arsimore dhe për menaxhimin efikas të mjeteve financiare. Shpenzimet në këtë kategori kanë përfshirë furnizime dhe shërbime të ndryshme, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e rregullt të shkollave, rritjen e sigurisë, mirëmbajtjen teknike dhe përmirësimin e kushteve të përgjithshme për nxënësit dhe stafin arsimor.

Projekte përkujtimore dhe kulturore

Në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të vlerave historike, kulturore dhe edukative, gjatë vitit 2025 janë realizuar projekte përkujtimore me rëndësi të veçantë për komunitetin shkollos dhe më gjerë. Është vendosur busti i Azem Bejtës në Grabanicë me vlerë 7,000.00 euro, si dhe busti i dëshmorit të kombit Ali Krasniqit në Ujmirë me vlerë 16,900.00 euro. Këto projekte shërbejnë si elemente edukative për nxënësit, duke kontribuar në kultivimin e ndjenjës së respektit për historinë, figurat kombëtare dhe trashëgiminë kulturore.

Përmirësimi i infrastrukturës elektrike

Gjatë këtij viti është realizuar edhe instalimi i kabllorës së energjisë elektrike në SHFMU “Motra Qiriazit”, me vlerë 5,000.00 euro. Ky investim ka përmirësuar furnizimin me energji elektrike, ka rritur sigurinë teknike të objektit shkollos dhe ka zvogëluar rrezikun nga defektet dhe ndërprerjet, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e procesit mësimor.

Siguria në institucionet arsimore

Rritja e nivelit të sigurisë në shkolla ka qenë një nga prioritetet kryesore të Drejtorisë së Arsimit gjatë vitit 2025. Në këtë drejtim, është lidhur një kontratë dyvjeçare për sigurimin fizik të objekteve shkollore, me vlerë totale prej 61,454.40 euro. Ky shërbim ka kontribuar në

mbrojtjen e objekteve shkollore, parandalimin e dëmtimeve dhe garantimin e një ambienti më të sigurt për nxënësit, mësimdhënësit dhe stafin tjetër shkollor.

Gjithashtu, është realizuar edhe sigurimi aksidental i nxënësve, me vlerë 1,461.60 euro, duke ofruar mbrojtje shtesë për nxënësit gjatë qëndrimit dhe aktiviteteve në shkollë.

Mirëmbajtja e objekteve shkollore

Për të siguruar funksionimin e rregullt dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të institucioneve arsimore, gjatë vitit 2025 është realizuar angazhimi i 14 punëtorëve teknik për një periudhë dyvjeçare, me vlerë totale prej 187.594 euro. Ky angazhim ka qenë thelbësor për ruajtjen e higjienës, mirëmbajtjen teknike dhe sigurimin e kushteve bazike në objektet shkollore, duke ndikuar drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e procesit arsimor.

Furnizimi me Materiale Higjienike dhe Materiale për Zyrë

Për të siguruar kushte të mira për mësimdhënie dhe administratë, janë realizuar furnizime me materiale të nevojshme:

- Material higjienik për shkolla në vlerë prej 12,806.99 euro. Ky furnizim ka kontribuar në mbajtjen e higjienës dhe pastrimin e ambienteve shkollore.
- Materiale për zyrë për administratën shkollore në vlerë prej 9,018.53 euro për përmirësimin e kushteve të punës dhe organizimin më të mirë të punës administrative.

Furnizimi me Material Sportiv

Për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe sportive, Drejtoria e Arsimit ka realizuar furnizimin me material sportiv në vlerë prej 21,184.40 euro. Ky investim ka mundësuar zhvillimin e aktiviteteve sportive, dhe ka kontribuar në rritjen e aftësive fizike dhe shëndetit të nxënësve.

Furnizimi me Lëndë Djegëse për Ngrohje

Për të siguruar ngrohjen e shkollave gjatë periudhës dimërore, është realizuar furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje në vlerë prej 77,223.00 euro, duke mundësuar që shkollat të jenë të ngrohta dhe të ofrojnë kushte të përshtatshme për mësim.

Sigurimi Aksidental për Nxënësit e IAAP “Fehmi Agani” Klinë

Në vitin 2025, Drejtoria e Arsimit ka siguruar një sigurim aksidental për nxënësit e IAAP “Fehmi Agani” Klinë gjatë zhvillimit të mësimin në vendin e punës, me një vlerë prej 1,461.60 euro. Ky sigurim ka për qëllim mbrojtjen e nxënësve nga çdo rrezik aksidental gjatë aktiviteteve praktike në terren, duke siguruar një mjedis të sigurt për zhvillimin e aftësive profesionale. Ky investim reflekton angazhimin e Drejtorisë për sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve në procesin edukativ.

Ndikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime

Shpenzimet e realizuara në kuadër të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në:

- rritjen e sigurisë fizike dhe teknike në shkolla;

- përmirësimin e kushteve të punës dhe mësimi;
- ruajtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore;
- forcimin e rolit edukativ dhe kulturor të institucioneve arsimore.

Këto masa përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të angazhimit institucional të Drejtorisë së Arsimit për krijimin e një sistemi arsimor funksional, të sigurt dhe të qëndrueshëm në Komunën e Klinës.

Subvencione dhe Aktivitetet e Zhvillimit Profesional

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Klinës ka kushtuar vëmendje të veçantë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve, me qëllim të mbështetjes direkte të nxënësve dhe studentëve, si dhe sigurimit të qasjes së barabartë në arsim për të gjithë. Kjo kategori ka pasur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve sociale të përfituesve dhe në garantimin e vijueshmërisë së rregullt të procesit mësimor, veçanërisht për nxënësit që vijnë nga zona rurale apo familje me kushte më të vështira ekonomike.

Buxheti i planifikuar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve gjatë vitit 2025 ka qenë 152,800.00 euro, nga i cili janë realizuar shpenzime në nivel 89.22%, duke dëshmuar një orientim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të mjeteve financiare drejt nevojave reale të nxënësve dhe studentëve.

Transporti i nxënësve

Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve nga kjo kategori është dedikuar për subvencionimin e transportit të nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në vlerë totale prej 76,323.14 euro. Ky subvencionim ka qenë i domosdoshëm për garantimin e vijueshmërisë së rregullt në shkollë për nxënësit që banojnë në zona më të largëta nga institucionet arsimore.

Transporti i nxënësve është realizuar në këto relacione dhe lokalitete:

- Shtupel – Klinë
- Klinafc – Klinë
- Zajm – Klinë
- Gjurgjevik i Vogël – Klinë
- Kosh – Zllakuqan
- Radulloc – Zllakuqan
- Krushevë e Madhe – Zllakuqan
- Lagjja Bakajes – Shtupel
- Qupevë e Ulët – Gremnik
- Qupevë e Lartë – Volljakë
- Dugajevë – Drenoc
- Pjetërq i Ulët – Drenoc

- Qeskovë – Këpuz
- Rastok – Këpuz
- Bokshiq – Grabanicë
- Dollovë – Grabanicë
- Shtaricë – Ujmirë
- Dobërdol – Ujmirë
- Resnik – Jashanicë
- Jelloc – Jashanicë etj

Trajnime për Zhvillimin Profesional të Mësuesve

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Arsimit ka organizuar trajnime për zhvillimin profesional të mësuesve, për të përmirësuar aftësitë profesionale dhe për të siguruar cilësi më të lartë në mësimdhënie. Këto trajnime janë zhvilluar në bashkëpunim me organizata të akredituara dhe institucione të tjera të arsimit, duke u siguruar mësuesve mjete dhe teknika moderne për të zhvilluar mësimdhënien.

Shpërndarja e Bursave për Studentët

Drejtoria e Arsimit ka shpërndarë 100 bursa, secila prej 600 euro, për studentët e Komunës së Klinës. Ky investim ka përfshirë një vlerë totale prej 60,000 euro, dhe ka mbështetur studentët në realizimin e qëllimeve të tyre akademike.

Organizimi i Garave dhe Olimpiadave

Nxënësit e Komunës së Klinës kanë marrë pjesë në një sërë garash dhe olimpiadash në fusha të ndryshme, përfshirë gjuha shqipe, matematika, gjuha angleze, fizika, dhe lëndë të tjera shkencore. Këto aktivitete kanë nxitur zhvillimin e talenteve të nxënësve dhe kanë kontribuar në ngritjen e nivelit të edukimit.

Testi i Arritshmërisë dhe Provimi i Maturës Shtetërore

Drejtoria e Arsimit ka administruar me sukses Testin e Arritshmërisë dhe Provimin e Maturës Shtetërore, duke siguruar një vlerësim të drejtë dhe të besueshëm të përgatitjes akademike të nxënësve dhe duke kontribuar në ngritjen e standardeve të arsimit në nivel lokal dhe kombëtar.

Organizimi i Ditës së shkollës

Përgjatë tërë vitit 2025 është organizuar Dita e shkollës në secilën prej shkollave në Komunën e Klinës dhe ne si DKA mbështetëm shkollat për një organizim sa më të mirë duke i'u ofruar zërim dhe materiale të nevojshme.

Bashkëpunimi me KFOR dhe Policinë e Kosovës

Drejtoria e Arsimit ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in dhe Policinë e Kosovës, duke përfutur nga donacionet e KFOR-it për shkolla, si dhe duke organizuar ligjëratat për sigurinë nga Policia e Kosovës. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në krijimin e një mjedisi të sigurt

për nxënësit dhe stafin arsimor dhe ka kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mësimdhënies.

Përfundimi i Raportit Vjetor të Drejtorisë së Arsimit për vitin 2025

Viti 2025 ka qenë një vit i mbushur me sfida të shumta, por njëkohësisht edhe me arritje të rëndësishme për sistemin arsimor në Komunën e Klinës. Përkundër vështirësive financiare dhe sfidave institucionale, Drejtoria e Arsimit ka dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm në realizimin e politikave arsimore, investimeve strategjike dhe aktiviteteve zhvillimore që kanë pasur për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe krijimin e kushteve më të mira për nxënësit, mësimdhënësit dhe të gjithë aktorët e arsimit.

Investimet kapitale kanë qenë një nga shtyllat kryesore të angazhimit institucional gjatë vitit 2025. Fokus i veçantë i është kushtuar përmirësimit të infrastrukturës shkollore, rritjes së sigurisë dhe modernizimit të ambienteve mësimore. Projekte si ndërtimi i fushave sportive, instalimi i sistemeve moderne të ngrohjes, furnizimi me tabela të mençura, si dhe ndërhyrjet në mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve shkollore, kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e një ambienti më funksional, më të sigurt dhe më bashkëkohor për procesin mësimor. Këto investime kanë reflektuar pozitivisht në motivimin e nxënësve dhe në përmirësimin e kushteve të punës për mësimdhënësit.

Në kuadër të mallrave dhe shërbimeve, Drejtoria e Arsimit ka siguruar funksionimin e rregullt të institucioneve arsimore përmes furnizimeve të domosdoshme, duke përfshirë transportin e nxënësve, sigurimin fizik të objekteve shkollore, mirëmbajtjen teknike, furnizimin me materiale higjienike, materiale për zyrë dhe lëndë djegëse për ngrohje. Këto shpenzime kanë qenë thelbësore për garantimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurt për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor, si në hapësirat e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme të shkollave.

Zhvillimi profesional i mësimdhënëseve ka vazhduar të mbetet prioritet gjatë vitit 2025. Përmes organizimit dhe mbështetjes së trajnimeve profesionale, është kontribuar në avancimin e kapaciteteve pedagogjike dhe profesionale të stafit arsimor. Këto trajnime kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, në zbatimin e praktikave bashkëkohore edukative dhe në rritjen e cilësisë së përgjithshme të procesit mësimor.

Në aspektin e mbështetjes për nxënësit dhe studentët, Drejtoria e Arsimit ka vazhduar me shpërndarjen e bursave për studentë, si dhe me mbështetjen e nxënësve në pjesëmarrjen e tyre në gara dhe olimpiada shkencore. Këto aktivitete kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e talenteve, në promovimin e konkurrencës pozitive dhe në rritjen e përfaqësimit të Komunës së Klinës në ngjarje arsimore në nivel lokal dhe më gjerë.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe sigurisë në shkolla. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in ka kontribuar në rritjen e nivelit të sigurisë për nxënësit dhe stafin arsimor, si dhe në realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe ligjëratave edukative për sigurinë. Përmes këtij bashkëpunimi janë realizuar edhe përfitime në formë donacionesh dhe mbështetjeje për institucionet arsimore.

Drejtorja e Arsimit ka vazhduar angazhimin e saj për ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, duke ofruar mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta dhe duke siguruar qasje të barabartë në arsim për të gjithë. Njëkohësisht, janë ndërmarrë masa për përmirësimin

e cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të nxënësve për sfidat e së ardhmes akademike dhe profesionale.

Në përfundim, mund të konstatohet se viti 2025 ka shënuar progres të dukshëm në zhvillimin e arsimit në Komunën e Klinës. Megjithëse sfida të caktuara vazhdojnë të jenë të pranishme, përfshirë edhe ato financiare dhe institucionale, Drejtoria e Arsimit mbetet e përkushtuar për t'i adresuar ato me përgjegjësi dhe transparencë. Me bashkëpunim të vazhdueshëm ndërinstitutional, përkrahje nga komuniteti dhe angazhim profesional të stafit arsimor, synojmë të krijojmë kushte edhe më të mira për çdo nxënës dhe mësimdhënës.

Duke u bazuar në arritjet e këtij viti, investimet kapitale, përmirësimet në infrastrukturë, zhvillimin profesional të stafit mësimor dhe mbështetjen e nxënësve, mund të konstatohet se Drejtoria e Arsimit ka kontribuar ndjeshëm në ngritjen e cilësisë së arsimit në Komunën e Klinës. Megjithëse sfida të ndryshme mbeten, përkushtimi ynë, bashkëpunimi institucional dhe mbështetja e komunitetit do të vazhdojnë të jenë faktorë kyç për ndërtimin e një sistemi arsimor më të fortë, të drejtë dhe gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për çdo nxënës dhe shërben si themel i një të ardhmeje të ndritur për brezat e ardhshëm.

Faleminderit të gjithë atyre që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë në zhvillimin e arsimit në Komunën e Klinës. Angazhimi i përbashkët mbetet çelësi për ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt, më cilësore dhe më të drejtë për brezat e ardhshëm.

3. DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës raporton punët e realizuara gjatë vitit 2025. Gjatë këtij viti, drejtoria ka funksionuar me stafin si në vijim:

- Udhëheqësi i sektorit për Pronësi;
- Udhëheqësi i sektorit për Gjeodezi dhe Kadastër;
- Zyrtarët për pranimin e qytetarëve;
- Zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP;
- Zyrtarët ligjorë;
- Zyrtari për shërbim pronëso-ro-juridik;
- Gjeodetë.

Punët kryesore të realizuara gjatë vitit 2025:

1. **Rritja e stafit punues.**
Janë rekrutuar gjeodetë dhe juristë shtesë për të përmirësuar kapacitetet e drejtorisë.
2. **Informimi i qytetarëve**
Është siguruar informimi i qytetarëve me kohë për miratimin ose refuzimin e kërkesave të tyre drejtuar Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
3. **Menaxhimi financiar**
Është mbajtur një raport tabelar i pagesave mujore të realizuara nga gjeodetët, zyrtarët përgjegjëse në RDPP dhe zyrtarët në sportel.
4. **Përfundimi i lëndëve të papërfunduara**
Janë përmbyllur kërkesat e papërfunduara nga gjeodetët e licensuar dhe janë procesuar lëndët e legalizimit të shtëpive, objekteve dhe lokaleve në gjeoportale.
5. **Ofrimi i shërbimeve në terren**
Shërbimet e matjeve në terren janë ofruar sipas nevojës, bazuar në kërkesat e drejtorive të Komunës së Klinës.
6. **Menaxhimi i lëndëve në Intranet**
Janë menaxhuar lëndët përmes sistemit të brendshëm të intranetit, duke përfshirë miratimin ose refuzimin e tyre.
7. **Vlerësimi i pronës dhe shpronësimi**
Është kryer vlerësimi i pronës për shpronësim dhe këmbime në zonën kadastrale


Klinë/Dresnik, si dhe janë kryer shpronësime për rrugën “Tranziti” dhe zonën e “Malushganit”

8. **Është implementuar projekti i rindërtimit të kadastrit-** me financim nga AKK në këto zona Kadastrale: Klinë, Dresnik, dhe Dush i Vogël. Në këtë projekt janë kryer matjet gjeodezike në terren, legalizimet, rregullimi i trashëgimisë, formalizimi zyrtar i kontratave mbi shitblerjet e tokave, etj.

Raporti sipas departamentit dhe statusit të zgjidhjes së lëndëve

Nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi paraqet të dhënat sipas statusit të zgjidhjes së lëndëve:

<u>Drejtoria</u>	<u>Pranuar</u>	<u>Në</u> <u>Proces</u>	<u>Miratuar</u>	<u>Refuzuar</u>	<u>Hedhur</u> <u>Poshtë</u>	<u>Pezulluar</u>	<u>Anuluar</u>	<u>Përfunduar</u>	<u>Total</u>
DKGJP	7	0	4,672	10	2	28	62	0	4,781



Pra, siç shihet në tabelë, gjatë periudhës njëvjeçare Janar–Dhjetor 2025, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur gjithsej 4,781 kërkesa përmes sistemit të intranetit. Në këtë numër nuk janë përfshirë kërkesat e pranuar nga Prokuroria, Gjykata, Policia dhe

drejtoritë komunale. Duke përfshirë edhe këto kërkesa, numri total sipas evidencave zyrtare arrin në 4800, të gjitha të regjistruara dhe të protokolluara.

GJATË VITIT 2025 NË DREJTORINË PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI KONSTATOJMË SE:

Janë lëshuar 4381 certifikata të pronësisë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar 49 certifikata që pala nuk posedon pronë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar 3648 kopje të planit me pagesë nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar 1004 certifikata të pronësisë pa pagesë për raste sociale nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar 281 certifikata të pronësisë pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar 281 kopje të planit pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës

Në bazë të kërkesave për legalizime, historiat pronësore, ekspertiza, marrëveshje të plotfuqishme gjyqësore, si dhe kërkesa nga hetuesia, prokuroria dhe drejtoritë tjera për dalje në terren, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur gjithsej **152 kërkesa**.

Po ashtu, tek zyrtarët përgjegjës për regjistrimin dhe modifikimin e të dhënave në RDPP kanë arritur gjithsej **1,515 lëndë**, për të cilat janë nxjerrë vendime individuale. Këto lëndë përfshijnë kryesisht kontrata noteriale, lëndë të gjeodetëve dhe vendime gjyqësore.

Për nevoja të ndryshme të qytetarëve, përveç trajtimit të kërkesave dhe dhënies së përgjigjeve për to, janë ofruar edhe shërbime shtesë, si:

- Lëshimi i certifikatave të pronësisë, certifikatave për raste sociale dhe certifikatave që dëshmojnë mosposedimin e pronës;
- Ofrimi i shërbimeve gjeodezike, përfshirë identifikimin e parcelave, lëshimin e kopjeve të planit dhe matjet për nevoja komunale, si dhe për kërkesa të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë;
- Sigurimi i hartave ortofoto dhe rindërtimi i informatave kadastrale në formë digjitale;
- Ofrimi i shërbimeve përmes sistemit informativ për tokën dhe pronën;
- Bartja e pronësisë bazuar në dokumente valide dhe të verifikuara nga noteri, gjykata dhe vendimet e organeve administrative.

RAPORTI PËRMbledhës I Të Hyrave Buxhetore Për Vitin 2025 SIPAS MUAJVE


Periudha: 01.01.2025 – 31.12.2025

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

Jana r	Shku rt	Mar s	Prill	Maj	Qers hor	Korr ik	Gus ht	Shta tor	Teto r	Nënt or	Dhje tor
4,03 2.00 €	4,20 3.00 €	4,07 4.00 €	4,28 9.00 €	5,66 0.00 €	5,794 .00 €	6,98 4.00 €	6,99 3.00 €	7,08 9.00 €	7,02 5.00 €	5,01 6.00 €	5,04 9.50 €

Të hyrat vjetore të realizuara në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi nga shërbimet në sportel, gjeodetët dhe zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP janë: 66,203.00 euro.

TË HYRAT (€)



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Të hyrat (€)	4032	4203	4074	4285	5660	5794	6984	6993	7089	7025	5016	5049.5

4. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Klinës gjatë vitit 2025 ka realizuar aktivitetet e saj në përputhje me Planin Vjetor të Punës dhe kompetencat ligjore të përcaktuara. Me një angazhim të vazhdueshëm institucional, drejtoria ka kontribuar në zhvillimin e jetës kulturore, rinore dhe sportive, si dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të komunës.

SEKTORI I KULTURËS

Sektori i Kulturës gjatë vitit 2025 ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve kulturore, artistike dhe përkujtimore, në bashkëpunim me institucione lokale, shkolla, organizata joqeveritare dhe krijues individualë. Aktivitetet kanë pasur për qëllim promovimin e vlerave kulturore, nxitjen e krijimtarisë artistike dhe përfshirjen aktive të qytetarëve.

Mes aktiviteteve kryesore të zhvilluara janë: ekspozita artistike, promovimi i librave, manifestime tradicionale, festivale folklorike, shfaqje teatrale, koncerte solemne dhe programe artistike për data me rëndësi historike dhe kombëtare.

Sektori i Kulturës ka realizuar punët sipas planit të punës, duke përfshirë edhe disa aktivitete që nuk ishin të parashikuara, të cilat po i listojmë më poshtë:

- **3 shkurt** – Hapja e ekspozitës personale të piktorit Azem Gashi në hollin e Galerisë së QK “Jehona e Dukagjinit”.
- **Shkurt** – Përgatitjet për organizimin e 17-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Aktivitetet kulturore të zhvilluara gjatë vitit:

- Orë letrare për Pavarësinë dhe promovimi i librit të autores Fatmire Berisha në Sallën e Kuvendit Komunal.
- Vizitë në ekspozitën e piktorit Azem Gashi.
- **Mars** – Filluan përgatitjet për Festivalin Folklorik “I këndojmë lirisë”, edicioni i 23-të.
- **8 mars** – Shënimi i “Ditës Ndërkombëtare të Gruas”, me orë letrare dhe hapjen e ekspozitës së piktoeve, një bashkëpunim i DKRS-së me Zyrën për Barazi Gjinore.
- **4 prill** – Akademi përkujtimore për Ditën e të Zhdukurve të Luftës në Klinë, në Palestrën Sportive “Adem Jashari”.
- **Prill** – Mbledhja e Këshillit Organizativ për Festivalin Folklorik “I këndojmë lirisë” dhe përgatitjet për festivalin.
- **23 prill** – Promovimi i librit monografik *Gjysmëshekulli i Shtëpisë së Kulturës “Jehona e Dukagjinit”*, me autorë Ismet Krasniqi dhe Prend Buzhala, në QK “Jehona e Dukagjinit”.
- Filluan provat e Ansambllit të Valleve.
- **25 prill** – Manifestimi tradicional “Zëri i vëllazërisë 2025” në QK “Jehona e Dukagjinit”.

- **3 maj** – Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë “Melodia”, edicioni i parë, organizuar nga OJQ “Rruga e Artit” dhe i mbështetur nga Komuna e Klinës.
- **16 maj** – Promovimi i librit publicistik *Kthimi i trurit* i autorit Ramiz Selimi në Sallën e Kuvendit Komunal.
- **17 maj** – Takim letrar me shkrimtarin Llesh Ndoj (Lezhë), bashkëorganizim i DKRS-së me Forumin e Intelektualëve “Luigj Gurakuqi” Klinë.
- **28 maj** – Përgatitjet e fundit për Festivalin Folklorik “I këndojmë lirisë”, edicioni i 23-të.
- **1 qershor** – Programi për Ditën e Fëmijëve, një aktivitet i ngjeshur dhe i shquar.
- **9 qershor** – Festa e Abetares në Shkollën Filllore “Motrat Qiriazit”.
- **6-8 qershor** – Festival Folklorik “I këndojmë lirisë”, edicioni i 23-të, i cili zgjati tri netë dhe u organizua në ditëlindjen e komandant Mujë Krasniqit, me hapjen zyrtare në Çabiq. Pjesëmarrës mbi 500 persona në skenë, me ansamble, shoqëri artistike, rapsodë me këngë dhe valle.
- **17 qershor** – Prova gjenerale për koncertin “Në Legjenda” të Shkodran Tolaj.
- **18 qershor** – Program artistik për Ditën e Çlirimit të Klinës, me këngë dhe valle nga AKV “Jehona e Dukagjinit” para Komunës së Klinës, dhe koncert solemn “Në Legjenda” nga Besiana & Të Mirët e Kombit në QK “Jehona e Dukagjinit”.
- **22-26 korrik** – “Camping Fest” edicioni i 7-të në Dresnik, Ujmirë, Klinë, organizuar nga OJQ “ArtEko” dhe i mbështetur nga Komuna e Klinës – DKRS. Ky festival promovon trashëgiminë kulturore, zhvillimin e turizmit lokal, afirmimin e vlerave kulturore dhe promovimin e prodhimeve vendore.
- **6 gusht** – Promovimi i librit *Familja Tomaj – Quni*, autorë Luz Tomaj dhe Mikel Çuni, në Sallën e Kuvendit Komunal.
- **21 gusht** – Ekspozita me fotografi “Kullat tona, Historia jonë” e autorit Besnik Goqi, në hollin e Galerisë së QK “Jehona e Dukagjinit”.
- **5 shtator** – Manifestimi tradicional “Ora e Tahir Deskut”, edicioni i 16-të, shpërblimi i veprës më të mirë letrare dhe ndarja e Çmimit “Tahir Desku”.
- **30 shtator** – Shfaqja teatrale “Këmisha e Lirisë” me aktoret Safete Rogova, Kumrije Hoxha dhe Igballë Qena, në QK “Jehona e Dukagjinit”.
- **26 nëntor** – Ekspozita tradicionale “ART Klina 2024”, edicioni i dhjetë, në hollin e Galerisë së QK “Jehona e Dukagjinit”, për nder të 28 Nëntorit.
- **27 nëntor** – Dy programe me këngë dhe valle në QK “Jehona e Dukagjinit”, nga SHFMU “Ismet Rraci” Klinë dhe AKV “Jehona e Dukagjinit”.

SEKTORI I RINISË

Sektori i Rinisë ka pasur fokus fuqizimin e të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore dhe publike. Aktivitetet e realizuara përfshinë takime, punëtori dhe projekte në bashkëpunim me organizata rinore lokale dhe ndërkombëtare.

Përfshirja e rinisë në projekte të ndryshme është mbështetur edhe nga bashkëpunimi me Qendrën Rinore “Ardhmëria” dhe organizata si OJQ “Zana”, OSCE dhe departamentet përkatëse.

Në kuadër të një projekti ndërkomunal, u zhvillua aktiviteti *"Promovimi i Dialogut Ndër-komunal"*, me pjesëmarrjen e komunave të rajonit të Dukagjinit: Pejë, Gjakovë, Istog, Deçan dhe Junik. Ky aktivitet u mbajt në Gjakovë dhe synonte forcimin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe pjesëmarrjes së rinisë në proceset sociale dhe kulturore.

SEKTORI I SPORTIT

Aktivitetet sportive kanë filluar në muajin janar dhe kanë vazhduar deri në dhjetor, me mbështetje nga organizata të ndryshme dhe klube sportive lokale.

Aktivitetet përfshinë turnire dhe gara të ndryshme, si:

- Futboll për të rinjtë
- Volejbol për femra
- Basketboll për meshkuj
- Shah
- Ping-pong

Gjithashtu, u organizua një turnir tradicional në nder të Dëshmorëve të Klinës, duke përfshirë edhe *Turnirin Mujë Krasniqi*.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka monitoruar dhe mbështetur zhvillimin e aktiviteteve sportive në hapësirat nën menaxhimin e saj, si dhe garat e klubeve të qytetit që marrin pjesë në ligat përkatëse të Kosovës.

Aktivitetet sportive kryesore:

Turniri për Ditën e Pavarësisë – 17 Shkurt:

- Futboll për të rinjtë
- Volejbol për femra
- Basketboll për meshkuj
- Shah – Mehmet Kryeziu
- Ping-pong
- Turniri për Ditën e Çlirimit
- Turniri tradicional për komandant Mujë Krasniqi dhe të gjithë Dëshmorët e Klinës

Takime informuese

Janë mbajtur takime informuese në bashkëpunim me QKMF "Nënë Tereza" dhe Stacionin Policor – Dega Klinë, me qëllim promovimin e shëndetit, sigurisë dhe edukimit sportiv të të rinjve.

Aktiviteti i projektit ndër-komunal: *"Promovimi i dialogut ndër-komunal"*

Ky aktivitet ka përfshirë komunat e rajonit të Dukagjinit dhe u mbajt në Gjakovë, me pjesëmarrjen e komunave të Pejës, Gjakovës, Istogut, Deçanit dhe Junikut. Projekti synonte forcimin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe pjesëmarrjen aktive të rinisë në aktivitete shoqërore dhe kulturore.

Ndarja e çmimeve për Sportistin e Vitit

U organizua ceremonia për ndarjen e çmimeve për sportistin e vitit dhe sportistët më të dalluar të klubeve sportive të qytetit.

Raporti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

Ky raport përfshin hapësirat sportive që Drejtoria ka nën menaxhim, si dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe garave të klubeve sportive të Klinës, të cilët marrin pjesë në ligat përkatëse të Kosovës.

Nr.	EMRI I ASETIT	HAPËSIRA NË M ²
1	Stadiumi i qytetit "18 Qershori"	15,563.28
2	Fusha ndihmëse e futbollit	7,700
3	Palestra sportive "Adem Jashari"	2,767
4	Fusha e tenisit	290
5	Fusha e volejbollit (ambient i jashtëm me rërë)	230
		Totali: 26,550.28

ZYRA PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Zyra për Trashëgimi Kulturorë ka realizuar projekte të rëndësishme për konservimin, restaurimin dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në territorin e Komunës së Klinës.

Në vitin 2025 janë restauruar objekte të rëndësishme, si:

- Mulliri "Isuf Halili" në Pjetërq të Epërm
- Kulla e "Gjon Mark Çunit" në Dresnik
- Kulla e "Nue Jakut" në fshatin Videj

Po ashtu, Zyra ka vazhduar procesin e inventarizimit të objekteve dhe ka përfshirë disa objekte të tjera në **Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme për vitet 2025–2026**, si Shtëpia e Nikollë Lush Rasit në fshatin Deiq.

Inventarizimi dhe Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore

Zyra ka vijuar procesin e inventarizimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në Komunën e Klinës. Si rezultat i këtij procesi, objekti "Shtëpia e Nikollë Lush Rasit", e vendosur në fshatin Deiq, është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2025–2026.

Menaxhimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar zbatimi i Planit të Menaxhimit për Lokalitetin Arkeologjik të Dresnikut, në kuadër të projektit *“Ruajtja dhe Mbrojtja e Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut”*. Ky projekt është financuar nga U.S. Ambassadors Fund for Cultural Preservation (AFCP) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa është implementuar nga Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij, në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Kosovës.

Projekti ka për qëllim menaxhimin, konservimin dhe zhvillimin e lokalitetit arkeologjik të Dresnikut. Gjatë vitit raportues, projekti ka përfunduar fazën përgatitore dhe aktualisht ndodhet në fazën e tenderimit, ndërsa implementimi në terren pritet të fillojë së shpejti.

Projekte të Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Gjatë vitit 2025 ka përfunduar projekti *“Rilindja Kulturore nga Ligeni i Shkodrës në Kosovë – ‘Udhëtimi në Kohë’”*, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe MNE-Kos, në partneritet me Komunën e Klinës. Ky projekt ka përfunduar në tetor të vitit 2025 dhe ka kontribuar në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe turistike të komunës.

Promovimi i Trashëgimisë Kulturore

Për promovimin e trashëgimisë kulturore në Komunën e Klinës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka subvencionuar projekte të ndryshme me qëllim promovimin, ndërgjegjësimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe historike të komunës.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Zyra për Trashëgimi Kulturore ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara, duke kontribuar në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Komunën e Klinës, si dhe duke krijuar baza të qëndrueshme për zhvillimin e projekteve të ardhshme.

ARKIVI HISTORIK I KLINËS

Arkivi Historik i Klinës, gjatë vitit 2025, ka qenë i angazhuar në sistemimin, rregullimin dhe digjitalizimin e materialit arkivor. Një prioritet i veçantë ka qenë ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe institucionet, përmes lëshimit të dokumenteve arkivore.

Në vazhden e punëve për sistemimin e lëndës arkivore, është punuar në rregullimin e materialit arkivor të këtyre fondeve.

Fondet e rregulluara				
Emri i Fondit	Vitet	Lëndë /gjatësi	Nr. kutive/ librave	Nr. i faqeve
Sekretariati i Punëve të Brendshme, Klinë	1964-1991	8.80 m	79	276 696

Administrata e UNMIK-ut, Klinë	2003	0.20 m	2 kuti	911
		Gjithsej metra: 9 m		Gjithsej faqe: 28 607

Lëndët e digjitalizuara

Emri i fondit	Vitet	Kuti	Dosjet	Faqe
Administrata Komunale e Klinës	1946-1992	2	1-21	2 131
BVI për Arsimin	1987-1999	1	9-28	490

Lëndët e regjistruara në PC

Emri i fondit	Ditarë Klase	Vitet
Gjimnazi “Luigj Gurakuqi” Klinë	277	1968-1981
Gjimnazi “Luigj Gurakuqi” Klinë, Paralelja në Kijevë	203	1970-1989

Krahas punës në rregullimin e lëndës arkivore, prioritet për arkivin ka qenë edhe puna me palë, pranimit të kërkesave, shqyrtimi i tyre dhe lëshimi i kopjeve nga origjinali.

Numri i kërkesave

Kërkesa të pranuar	Të realizuara	Të parealizuara (për shkak se lënda nuk gjendet në arkiv)	Kopje A3 të lëshuara	Kopje A4 të lëshuara
106	82	24	204	179

BIBLIOTEKA E QYTETIT “KONGRESI I MANASTIRIT”

Biblioteka ka vazhduar të mbajë dhe të menaxhojë fondin librar, duke organizuar aktivitete për promovimin e leximit dhe edukimin e fëmijëve dhe të rinjve. Gjatë vitit **2025**, fondi librar është pasuruar me dhurata nga autorë dhe personalitete akademike.

Biblioteka ka ofruar shërbime për **337 lexues aktivë** dhe ka organizuar aktivitete edukative dhe orë letrare, duke përfshirë edhe vizita nga shkolla të ndryshme.

Duke u bazuar në planifikimin e punës për vitin **2025**, janë realizuar shumica e punëve të planifikuara, përfshirë përpunimin dhe regjistrimin e librave, mbajtjen e evidencës së lexuesve, si dhe trajtimin e kërkesave të vazhdueshme për huazimin, ruajtjen dhe kthimin e librave në bibliotekë. Po ashtu, janë organizuar orë letrare dhe vizita të nxënësve në bibliotekë.

Në lidhje me pasurimin e fondit librar, gjatë këtij viti janë hasur disa vështirësi, sidomos për shkak të mungesës së mbështetjes nga buxheti komunal dhe nga **Ministria e Kulturës**, të cilat nuk kanë ofruar mbështetje financiare.

Në muajin **prill**, biblioteka ka pritur vizita nga nxënësit e shkollës fillore “**Motrat Qiriaz**” në Klinë, si dhe nga paralelet e Zajmit, të cilët janë njoftuar me kushtet dhe mundësitë që ofron biblioteka për lexuesit.

Me rastin e **Ditës Botërore të Librit**, më **23 prill**, janë realizuar vizita nga nxënës të shkollave të **Siqevës** dhe **Jashanicës**, të cilët janë njoftuar me ambientet dhe kushtet e bibliotekës.

Më **3 shtator**, biblioteka ka pasur vizitë nga **prof. dr. Rexhep Doqi**, i cili, gjatë kësaj vizite, ka dhuruar disa libra të tij personale, si dhe një numër të konsiderueshëm librash nga biblioteka e tij personale.

Po ashtu, më **17 tetor**, bibliotekën e kanë vizituar nxënësit e shkollës nga fshati **Shtupel**, paralelet **I–V**, të cilët janë njoftuar me kushtet dhe ambientin e bibliotekës, si dhe me mundësitë që ajo ofron për materiale shkollore dhe lektura të ndryshme për nxënësit.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e **Ditës së Alfabetit të Gjuhës Shqipe**, biblioteka ka pritur vizita nga nxënësit e shkollës fillore “**Ismet Rraci**”, të cilët janë njoftuar me ambientet e bibliotekës dhe me **Kongresin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe**, të mbajtur në Manastir në nëntor të vitit 1908. Po ashtu, janë realizuar vizita edhe nga nxënësit e shkollave të **Jashanicës**, **Ujmirit** dhe **Siqevës**.

Gjatë këtij viti është shënuar një numër më i vogël i lexuesve krahasuar me vitet e kaluara. Gjithsej janë regjistruar **337 lexues aktivë**, përfshirë nxënës dhe qytetarë nga shtresa të ndryshme shoqërore. Po ashtu, gjatë vitit janë dhuruar **187 ekzemplarë** me **150 tituj** nga autorë të ndryshëm.

Në total, biblioteka numëron gjithsej **33 249 libra**.

5. DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Me fillimin e vitit 2025 është hartuar plani i punës, në bazë të të cilit Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka realizuar të gjitha punët dhe aktivitetet e saj.

Përveç planit vjetor të punës, Drejtoria e Bujqësisë ka kryer edhe detyra që rrjedhin nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), veçanërisht: aplikimin e fermerëve për subvencione, raportimin e realizimit të mbjelljeve të kulturave bujqësore, korjeshirjeve, ndërrimin e destinimit të tokës nga pyjore në bujqësore sipas kërkesave të fermerëve, raportimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, organizimin e shërbimeve këshillimore, etj.

Subvencionet dhe aplikimet

Më datë 15.01.2025 ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencionimin e qumështit, majmërisë së vëçave dhe therjeve të raportuara të gjedhit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2024. Ky proces, i mbështetur nga MBPZHR, ka zgjatur deri më 14.02.2025.

Duke pasur parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë herët, Drejtoria ka përgatitur paraprakisht planin e mbjelljeve pranverore dhe, njëkohësisht, ka këshilluar fermerët që të zbatojnë masat agroteknike, të respektojnë afatet dhe të përdorin fara cilësore dhe të certifikuara, me qëllim të arritjes së rendimenteve sa më të larta.

Plani i mbjelljeve pranverore për vitin 2025

Kultura	Sipërfaqe e planifikuar (ha)	Sipërfaqe e realizuar (ha)
Misër	2,970	2,980
Tërshërë	220	215
Perime	200	195
Patate	140	135
Bimë foragjere	775	770
Lulediell	85	85
Të tjera	80	80
Gjithsej	4,470	4,460

Siç shihet nga tabela, plani i mbjelljeve pranverore është realizuar pothuajse në tërësi, me disa devijime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve. Gjatë gjithë kësaj periudhe, zyrtarët e Drejtorisë kanë monitoruar vazhdimisht procesin e mbjelljeve në terren.

Më datë 03.04.2025 ka filluar aplikimi për subvencionet e mbështetura nga MBPZHR – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, për pagesa direkte për sipërfaqe dhe për blegtori. Subvencionet kanë përfshirë kultura bujqësore si: grurë, misër, thekër, tërshërë, elb, lulediell, pemë frutore, pemë të imta, perime (spec, domate, patate, lakër, qepë, hudhër, kungull), si dhe bimë aromatike. Në blegtori, subvencionet janë dhënë për krerë bagëtish: lopë qumështore, dele, dhi, dosa, bletë dhe pula vojse.

Drejtorja ka njoftuar fermerët për afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim. Procesi ka shkuar shumë mirë dhe numri i aplikuesve ka qenë më i madh krahasuar me vitin paraprak. Duke pasur parasysh afatin e shkurtër, stafi ka punuar edhe jashtë orarit zyrtar për të mundur aplikimin e të gjithë fermerëve. Afati i aplikimit ka zgjatur deri më 19.05.2025 dhe gjithsej kanë aplikuar **1,165 fermerë**.

Korrje-shirjet dhe monitorimi

Para fillimit të korrje-shirjeve është formuar komisioni komunal për përcjelljen e kësaj fushate. Komisioni ka monitoruar procesin, ka inspektuar autokombajnat për gjendjen teknike dhe ka këshilluar fermerët që të mos bëjnë djegien e hamulloreve, duke marrë parasysh dëmet që shkaktohen në tokën bujqësore dhe në mjedis.

Rendimenti i grurit gjatë këtij viti ka qenë shumë i mirë, falë kushteve klimatike të favorshme dhe mungesës së sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Nga data 01.08.2025 deri më 12.09.2025 ka qenë i hapur aplikimi për dorëzimin e dëshmimeve për sasinë e grurit të dorëzuar në pikat grumbulluese, si dhe për qumësht dhe viça për majmëri. Dokumentacioni i kompletuar është dërguar në MBPZHR – Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Në këtë fazë kanë aplikuar gjithsej **695 fermerë**.

Projektet e realizuara

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar këto projekte:

- Projekt për sera (32 m²) – 100 përfitues
- Motokultivatorë – 100 përfitues
- Freza – 216 përfitues
- Spërkatëse – 55 përfitues
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes Stupë, Budisalc, Krushevë e Madhe

Këto projekte kanë kontribuar në rritjen e prodhimit bujqësor, modernizimin e punës në ferma, uljen e kostove të prodhimit dhe rritjen e efikasitetit në shfrytëzimin e tokës bujqësore. Pajisjet bujqësore kanë lehtësuar punën e fermerëve dhe kanë mundësuar përgatitje më cilësore të tokës, mbrojtje më efikase të kulturave bujqësore dhe rritje të rendimenteve.

Ndërtimi i kanalit të ujitjes ka përmirësuar ndjeshëm furnizimin me ujë për sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore, duke zvogëluar varësinë nga kushtet klimatike dhe duke krijuar siguri më të madhe për prodhim të qëndrueshëm. Në tërësi, këto projekte kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave të ekonomive familjare, përmirësimin e kushteve të jetesës së fermerëve dhe zhvillimin afatgjatë të bujqësisë në komunë.

Shërbimet këshillimore dhe trajnimet

Përveç punës në zyrë, stafi i Drejtorisë ka realizuar vizita të rregullta te fermerët e profileve të ndryshme: lavërtarë, bletarë, pemëtarë dhe blegtorë, duke i mbështetur me këshilla profesionale dhe orientim drejt një bujqësie të qëndrueshme. Gjithashtu, janë shpërndarë broshura informative me dhjetë tema nga fusha e bujqësisë.

Në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Këshillimore të MBPZHR-së, nga fundi i muajit qershor deri në dhjetor janë organizuar trajnime për fermerë me temat:

- Krasitja e pemëve
- Higjiena në fermat e gjedhit
- Kultivimi i misrit

- Përgatitja e rotoballeve, barit të njomë dhe silazhit
- Sëmundjet dhe dëmtuesit e bletëve dhe përgatitja për dimër
- Ushqimi i kafshëve gjatë vjeshtës dhe dimrit
- Kultivimi i grurit – varietete produktive

Në këto trajnime kanë marrë pjesë mbi 187 fermerë, të cilët kanë përfituar edhe nga përvoja praktike.

Mbjelljet vjeshtore 2025/2026

Para fillimit të mbjelljeve vjeshtore është hartuar plani përkatës, i paraqitur më poshtë:

Kultura	Sipërfaqe e planifikuar (ha)	Sipërfaqe e realizuar (ha)
Grurë	4,595	4,585
Elb	120	115
Thekër	50	40
Foragjere	515	510
Gjithsej	5,280	5,250

Kushtet klimatike gjatë këtij viti kanë qenë shumë të favorshme, duke ndikuar në rritjen e sipërfaqeve të mbjella, veçanërisht me kulturën e grurit.

Bashkëpunimi dhe aktivitetet promovuese

Drejtorja e Bujqësisë ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me MBPZHR-në, organizatat joqeveritare dhe drejtoritë komunale të bujqësisë të komunave të tjera, në shkëmbim të përvojave dhe praktikave të mira.

Në kuadër të Festivalit “Këndojmë Lirisë” është organizuar Panairi i Produkteve Bujqësore, ku fermerët e Komunës së Klinës dhe të komunave të tjera kanë ekspozuar produktet e tyre për tri ditë radhazi.

6. DREJTORIA E INSPEKTORATIT

Duke u udhëhequr nga parimet themelore të ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe interesit publik, efikasitetit, dëgjimit të palëve në procedurë, vlerësimit të lirë të provave, vendosjes së drejtë dhe plotfuqishmërisë së aktvendimeve, Drejtoria për Punë Inspektuese e Komunës së Klinës ka përmbushur planin e saj të punës në pikat më kyçe, si: kontrolli inspektues i zbatimit të ligjshmërisë në fushën e shërbimeve publike, ndërtimit, bujqësisë dhe ambientit, tregut, komunikacionit/trafikut, si dhe legalizimi i ushtrimit të veprimtarive afariste të subjekteve ekonomike dhe joekonomike, etj.

Me qëllim të ndërtimit të një strategjie afatgjate për jetësimin e sundimit të ligjit dhe luftimin e informalitetit, përkatësisht veprimeve kundërligjore të subjekteve që i nënshtrohen kontrollit inspektues, organet e Drejtorisë për Punë Inspektuese, gjatë periudhës raportuese, kanë ndërmarrë një sërë aktivitete dhe veprimesh koordinuese, në bashkëveprim edhe me Policinë e Kosovës, në: kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve; kontrollin e bizneseve; mbikëqyrjen e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK-së dhe KEDS-it; parandalimin e dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike; respektimin e orarit të punës së bizneseve hoteliere, sidomos gjatë orëve të vona të natës; mbarëvajtjen e tregjeve javore; mbikëqyrjen e transportit publik; mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit; si dhe kontrollin e artikujve ushqimorë dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësore dhe afatit të përdorimit.

Në ndërlidhje me këto aktivitete, nga ana e Drejtorisë janë nxjerrë një numër i konsiderueshëm aktesh – urdhëresa ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Duhet theksuar se organizimi i punëve dhe detyrave nga ana e eprorit dhe inspektorëve, përveç orarit të rregullt të punës, është realizuar edhe gjatë fundjavave, festave fetare dhe shtetërore, përmes caktimit të kujdestarive dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera e taksave, tarifave dhe ngarkesave, si dhe në shqiptimin e gjobave për shkelje ligjore, është inkasuar shuma prej 6,477.20 €, ndërsa në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjieno-teknike të hapësirave punuese ku ushtrohet veprimtaria ekonomike janë inkasuar 5,268.00 €. **Në total, të hyrat për vitin 2025 janë 11,745.20 €.**

Nga personat fizikë dhe juridikë, në nivel të Drejtorisë janë proceduar gjithsej **237** kërkesa, prej të cilave **213** janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës ligjore. **10** kërkesa janë refuzuar si të pabazuara, **10** janë pezulluar, **2** janë anuluar dhe **2** kanë mbetur në proces.

Me qëllim të informimit të ndërsjellë ndërmjet organeve të Inspektoratit, Drejtorisë, drejtorive të tjera komunale, Kryetarit të Komunës, si dhe në raport vertikal me Qeverinë dhe ministrinë përkatëse, janë hartuar informata, raporte, memorandume dhe relacione të tjera zyrtare, si sipas kërkesës ashtu edhe sipas detyrës zyrtare. Duke analizuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara, konstatohet se gjatë ushtrimit të kontrollit inspektues paraqiten edhe vështirësi

dhe pengesa, veçanërisht mungesa e numrit të mjaftueshëm të inspektorëve në raport me numrin e banorëve të komunës.

Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, puna e secilit organ inspektues veç e veç, pa pretenduar që të shkoqiten në detaje punët rutinore, të cilat janë të përcaktuara me fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

INSPEKTIMI NË LËMIN PUBLIK

Në këtë lëmë, gjatë periudhës raportuese, janë ushtruar **78** mbikëqyrje inspektuese, nga të cilat kanë rezultuar **55** procesverbale të përpiluara në vend. Objekt i kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësi, rrjeti elektrik dhe i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorë të tjerë në aksione të përbashkëta, inspektimi i tarracave në hapësirat publike, dalja në vend si dhe shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizikë dhe juridikë të natyrës përkatëse. Po ashtu, gjatë stinës së dimrit është bërë organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirim të rrugëve nga reshjet, si dhe kryerja e punëve të tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij.

Aktivitetet e kryera përfshijnë:

- Inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike nga dëmtimet, kyçjet ilegale, dëmtimi i rrugëve dhe veprimet e tjera ilegale.
- Inspektimi dhe largimi i pengesave të ndryshme (panove, reklamave të ndryshme, tarracave etj.) nga sipërfaqet publike, të cilat nuk janë të pajisura me pëlqim nga organet kompetente.
- Inspektimi dhe largimi i shitësve ambulantë dhe pengesave të tjera, si dhe mbikëqyrja e mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve dhe varrezave.
- Tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve të tjera publike, mbikëqyrja e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, si dhe mbikëqyrja e zbrazjes pa leje të materialeve (rërës, dheut, materialeve të tjera ndërtimore).
- Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, sipas ankesave të qytetarëve.
- Shqiptimi i gjobave dhe përpilimi i procesverbaleve për mosrespektim të urdhrave të inspektorëve.

Janë shqiptuar gjithsej **5** gjoba në vlerë prej **350.00** euro, për ushtrim të veprimtarisë tregtare në vende të palejuara, mosrespektim të afatit për aplikim për shfrytëzim të hapësirës publike, si dhe mosrespektim të afatit kohor të caktuar për kthim në gjendje të mëparshme.

INSPEKTIMI NË LËMIN E NDËRTIMIT

Në këtë sektor, në mungesë të inspektorit të ndërtimit, duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese përmes komisioneve inspektuese të përbëra nga të gjithë inspektorët, në zbatim të dispozitave ligjore nga lëmi i ndërtimit, janë ushtruar gjithsej **45** kontrole, duke përfshirë edhe ato monitoruese inspektuese. Janë hartuar **30** procesverbale në vend dhe janë inspektuar, si dhe mbajtur nën kontroll, të gjitha objektet e reja dhe ato që kanë qenë në ndërtim e sipër nga vitet

e kaluara, duke përfshirë këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie gjatë ditëve të vikendit dhe festave të ndryshme.

Po ashtu, është koordinuar dhe bashkëvepruar me inspektorët e tjerë në kuadër të Drejtorisë në punë të përbashkëta, si në punët e tregjeve javore, inspektimin e tarracave në hapësirat publike së bashku me Inspektorin e Shërbimeve Publike, në kuadër të mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit, etj. Nga ky organ janë shqiptuar 5 gjoba në vlerë prej **2,250.00 €**.

INSPEKTIMI NË LËMIN E KOMUNIKACIONIT/TRAFIKUT

Ky organ inspektues, gjatë vitit raportues 2025, ka ushtruar mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtjen e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, si dhe vendosjen sipas kërkesave të palëve, etj. Në lidhje me këto aktivitete janë hartuar **42** procesverbale, janë lëshuar **35** aktvendime dhe janë inkasuar **930.00 €**, për lëvizjen e mjeteve që tejkalojnë peshën mbi 3.5 tonë në zonën e ndaluar për qarkullim në pjesën qendrore me kalldrëm.

Në total, realizimi i të hyrave në lëmin e komunikacionit për vitin 2025 është **930.00 €**. Po ashtu, janë evidentuar monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve, si brenda lokalitetit të Klinës, ashtu edhe jashtë tij, përkatësisht në qendrat e lokaliteteve në territorin e Komunës së Klinës.

Është asistuar në vendosjen dhe shenjëzimin e shenjave vertikale dhe horizontale në qytet dhe në fshatrat e Komunës së Klinës. Gjithashtu, janë hartuar procesverbale dhe dokumentuar me fotografi punët e kryera, si në vijim:

- Vendosja e vendkalimeve për këmbësorë në sipërfaqe prej rreth 800 m²;
- Vendosja e afërsisht 85 shenjave të komunikacionit në tërë territorin e Komunës së Klinës, në rrugët ekzistuese dhe në rrugët e asfaltuara gjatë vitit 2025, përfshirë shenja rreziku, lajmërimi dhe urdhrash të prerë;
- Furnizimi dhe realizimi i vijës ndarëse të shiritave të qarkullimit në gjatësi prej rreth 9,000 metrash linearë;
- Furnizimi dhe vendosja e 15 pasqyrave të trafikut, të formës rrethore ose drejtkëndëshe;
- Furnizimi dhe pajisja e vendkalimeve hekurudhore nuk është realizuar gjatë vitit 2025, pasi të gjitha vendkalimet, me gjithsej 162 shenja, janë kompletuar në vitin 2024;
- Vendosja e 3 shenjave për vendndalimet e autobusëve;
- Shenjëzimi i 52 vendeve të parkingut në 5 lokacione brenda qytetit, si dhe shtimi i 4 vendeve të parkingut për persona me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, është bashkëvepruar me organet e tjera inspektuese në aksione të përbashkëta, të planifikuara nga Drejtoria.

INSPEKTIMI NË LËMIN E BUJQËSISË DHE AMBIENTIT

Në këtë sektor, në mungesë të inspektorit përkatës, mbikëqyrja inspektuese është ushtruar përmes komisioneve inspektuese të përbëra nga të gjithë inspektorët, në zbatim të dispozitave ligjore nga lëmi i bujqësisë dhe ambientit.

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2025, nga lëmi i inspektimit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar aktivitetet në vijim:

- Inspektime të shfrytëzuesve të resurseve natyrore, si rëra, guri dhe zhavorri;
- Verifikimi i bartjes së zhavorrit me mjete transportuese, për të konstatuar nëse janë të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm apo kryejnë bartje ilegale;
- Inspektime për hedhje të mbeturinave në hapësira publike;
- Inspektime për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit;
- Kontrollë për kualitetin e prodhimeve bujqësore;
- Kontrollimin e barnatoreve bujqësore, nëse janë të pajisura me aktvendime për ushtrimin e veprimtarisë.

Nga këto aktivitete janë realizuar gjithsej **54** kontrolle inspektuese, prej të cilave janë hartuar **43** procesverbale mbi konstatimin e gjendjes, si dhe janë shqiptuar **6** gjoba, përkatësisht: **1** gjobë për shfrytëzim dhe bartje ilegale të zhavorrit, **4** gjoba për hedhje të mbeturinave në hapësira publike dhe **1** gjobë për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit. Gjatë vitit 2025 janë inspektuar të gjitha objektet dhe veprimtaritë e tjera që posedojnë leje mjedisore komunale. Numri i objekteve të pajisura me leje mjedisore komunale është 21 dhe të gjitha këto zbatojnë rregullativat mjedisore sipas LMK-së. Po ashtu, gjatë vitit 2025 janë shqiptuar gjoba për mosposedim apo moszbatim të LMK-së, ndërsa nuk ka pasur fletëparaqitje në gjykatë. Në total, realizimi i të hyrave për vitin 2025 është **627.20 €**.

INSPEKTIMI NË LËMIN E TREGUT

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike dhe e qarkullimit të mallrave, si dhe mbi bazën e obligimit ligjor për përpilimin dhe evidentimin e shënimeve dhe të dhënave për punën dhe aktivitetin e ushtruar gjatë vitit 2025, më poshtë paraqiten punët dhe aktivitetet e organit të Inspektoratit të Tregut, sipas strukturës dhe tipeve të kontrollit të ushtruar ndaj subjekteve që i janë nënshtruar mbikëqyrjes inspektuese, në zbatim të dispozitave ligjore pozitive të Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Ligjit për Tregtinë e Brendshme, Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, si dhe ligjit për Njësitë Matëse.

Mbikëqyrja ka përfshirë kushtet e ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, kualitetin e produkteve industriale dhe ushqimore, cilësinë e shërbimeve, verifikimin e regjistrimit (pajisjen me certifikata për regjistrimin e biznesit) të të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve të tjera, si dhe pajisjen me aktvendime. Janë hartuar gjithsej **85** procesverbale mbi faktimin e gjendjes, të cilat i referohen të njëjtit aktivitet për përcaktimin e veprimeve dhe procedimin e mëtejshëm administrativo-procedural. Në kuadër të punës në Komisionin Inspektues për përcaktimin e kushteve minimale

teknike dhe sanitare-higjienike, janë pajisur **45** lokale me aktvendime dhe janë inkasuar **5,268.00 €** nga bizneset, përmes urdhërpagesave të realizuara në emër të taksës përkatëse.

Në koordinim me Zyrën për Biznese, është punuar për zgjidhjen e kërkesave që lidhen me lejen për zgjatjen e orarit të punës së subjekteve afariste në fushën e hotelerisë dhe kafeterive, në përputhje me Rregulloren përkatëse komunale. Gjatë këtij procesi, është regjistruar vetëm një rast i tillë.

Në bashkëveprim me Inspektorin Sanitar dhe inspektorë të tjerë, është larguar nga qarkullimi mall dhe produkte ushqimore me afat të skaduar përdorimi, të prishura ose pa deklaracion për shitje, ku është inkasuar shuma prej **30.00 €** në emër të taksës për punën komisionare, konform Rregullores për Taksat, Ngarkesat dhe Tarifat, ndërsa vlera e mallit të asgjësuar ka qenë **11,265.39 €**. Janë shqiptuar gjopa ndaj subjekteve dhe individëve për shkelje ligjore, të përcaktuara me dispozita ligjore, gjatë ushtrimit të aktivitetit afarist apo veprimtarive të ngjashme, në **6** raste, në vlerë totale prej **3,250.00 €**.

Në total, realizimi i të hyrave nga sektori i tregut për vitin 2025 është **8,548.00 €**. *Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve për vitin raportues nuk është përfshirë puna e realizuar, qoftë vetanake apo në bashkëveprim me Inspektorët e Tregut pranë MTI-së, sipas Planit të Veprimt të Inspektoratit të Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, për të cilat ka qenë e nevojshme korrespondimi dhe raportimi sipas një vije të veçantë.*

PROPOZIMI I MASAVE:

Duke u bazuar në konstatimet e sipërshënuara dhe efektet e arritura gjatë periudhës raportuese, paraqitet domosdoshmëria e ndërmarrjes së masave dhe veprimeve si në vijim:

Shtimi i numrit të inspektorëve sipas standardeve ligjore, në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve në komunë.

7. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBOJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës, gjithë fushëveprimtarinë e vet e ushtron në bazë të dispozitave ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve të Asamblesë Komunale. Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, veprojnë:				
Shërbimi i Ndërtimit dhe Banimit	Në kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:	-Punë dhe aktivitete në fushën e ndërtimit dhe banimit		
Zyra për Mbrojtje të Mjedisit		- Legalizimi i objekteve		
Planifikimi Urban		- Urbanizëm dhe planifikim hapësinor		
Zyra për Projekte		-Pajisja me leje mjedisore komunale		
		-Mirëmbajtja e sistemit të adresave		
		- Hartimi i paramasave dhe parallogarive, përgatitja e projekt-propozimeve, raporteve teknike, procesverbaleve dhe shkresave të ndryshme		
		-Menaxhimi dhe mbikëqyrja e ecurisë së punimeve për të gjitha projektet në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive të tjera, përfshirë pranimet teknike dhe inspektimet në terren sipas kërkesave të palëve		
Gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.12.2025 në këtë Drejtori janë pranuar 1,072 lëndë, prej të cilave: 83 kërkesa për leje ndërtimi, ndërsa të tjerat janë kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për leje mjedisore komunale, kërkesa për legalizim, fatura dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.				
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ka marrë vendime si më poshtë:				
768 lëndë të miratuara, prej të cilave:				
Kushte ndërtimi	Leje ndërtimi	Leje mjedisore	Leje legalizimi	Leje rrënimi
82	81	21	39	1
Ndërsa 544 lëndë janë: referenca, vërtetime, pëlqime, procesverbale, vendime, fatura, njoftime, shkresa dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.				

Lëndë në proces	Lëndë të refuzuara	Lëndë të pezulluara	Lëndë të hedhura poshtë	Lëndë të anuluar	Lëndë të pranuar	Lëndë të ceduar
115	76	67	3	32	10	1

Gjatë këtij viti, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka realizuar të hyra buxhetore në vlerë prej **318,384.27 €**, të siguruar nga lejet e ndërtimit, kushtet e ndërtimit, lejet mjedisore komunale, legalizimet, pëlqimet dhe shërbime të tjera.

Po ashtu, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka menaxhuar, mbikëqyrur dhe realizuar projektet si më poshtë:

Kontratat 2024-2025

N R	Nr. i kontratës	Emërtimi i kontratës	Vlera e kontratës 2023-24-25 (€)	Rrugë të asfaltuara (m)	Kanalizim fekal (m)	Ujësjellës (m)	Trotuar	Ndriçim elektrik (m)	Kanalizim atmosferik (m)	Përfundimi projektit
1	84-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Zllakuqan-Pataqan -Berkovë	119,804.00		600		900	900		Përfunduar
2	78-2024	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë	649,909.00				700	700	1200	Vazhdon
3	91-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104, Lot-1	1,709,978.00			900.00			500.00	Vazhdon

4	92-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104, Lot-2	1,977,619.35	700.00		700.00				Vazhdon
5	93-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104, Lot-3	1,154,823.27	800.00		500.00				Vazhdon
6	94-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104, Lot-4	1,420,000.77							Vazhdon
7	95-2024	Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104, Lot-5	2,023,000.00	800.00		800.00	800.00		800.00	Vazhdon
8	97-2024	Projekte zbatuese	300,000.00							Vazhdon
9	85-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Ranoc-Leskoc	49,978.00	180.00						Vazhdon
10	12-2024	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim në fshatin Pjetërq dhe Ndërtimi i rrugëve Pjetërq-Dugajevë-Drenoc	214,815.00	1000.00	750.00		1100.00	1100.00		Përfunduar
11	15-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Klinë-Shtupel-Kërrnicë	299,000.00	2144.00						Përfunduar
12	17-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore	169,999.82	350.00	100.00		170.00	170.00		Përfunduar

		Grabanicë-Bokshiq-Dollovë								
13	83-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë	64,941.00		800.00					Përfunduar
14	74-2024	Asfaltimi i rrugës Pjetërq-Dugajevë	204,000.00	1850.00						Përfunduar
15	40-2023	PZHK	27,376.00							Përfunduar
16	89-2025	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza 2	4,399.00							Përfunduar
17	110-2023	Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë	849,921.63							Përfunduar
18	92-2025	Punë shtesë-Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Ranoc-Leskoc	54,265.84	100.00						Vazhdon
19	37-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Krushevë e Madhe	79,550.00	550.00						Vazhdon

20	13-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Sferkë-Volljakë-Qupevë	249,500.00	3500.00	500.00					Përfunduar
21	20-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Madh	99,944.50	1100.00	1000.00					Përfunduar
22	72-2024	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Malë Bashota, Prekë Prendi, Dosidej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktura nëntokësore Klinë-Dollc-Dresnik	349,999.00	3500.00	3500.00					Përfunduar
23	52-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Jashanicë-Pograxhë-Resnik, si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastruktura rrugore në Grykën e Jarinës-Pograxhë-Jashanicë	225,428.00	2400.00	2500.00		1300.00	1300.00		Përfunduar
24	42-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Këpuz-Rastokë	61,190.00	300.00	1950.00					Përfunduar

25	41-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogël-Klinafe	104,997.00	1250.00	1300.00						Përfunduar
26	39-2024	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë	82,000.00	1250.00	100.00						Përfunduar
27	108-2024	Ndërtimi i shtratit Lumëbardhi i Pejës Drenoc-Grabanicë	31,550.00						300.00		Vazhdon
28	105-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Ranoc-Leskoc	17,485.50	100.00							Vazhdon
29	86-2025	Ndërtimi i urës automobilistike në Dugajevë	439,902.54								Vazhdon
30	73-2025	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dosidej Obradoviq, Bekim Fehmiu, Shaban Sadiku dhe infrastruktura nëntokësore Klinë-Dresnik-Dollc	844,200.92	400.00	1000.00						Vazhdon
31	35-2025	Ndërtimi i kanalizimit Shtupel-Kërrnicë-Binxhë-Grabc, faza 2	129,000.00		5000.00						Vazhdon

32	68-2025	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljakë etj, faza II	34,891.00	40.00							Përfunduar
33	57-2025	Punë shtesë - Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Pjetërqi-Dugajevë-Drenoc	21,089.50								Përfunduar
34	36-2025	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore (trotuar) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq	216,000.00	700.00							Vazhdon
35	51-2025	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalc-Rudicë	49,976.00	550.00	100.00						Vazhdon
36	52-2025	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe rindërtimi i rrugës: Klinë-Shtupel-Kërrnicë	69,999.99								Vazhdon
37	55-2025	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore në Siquevë-Ujmirë-Shtaricë	59,999.00	600.00							Vazhdon

38	98-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Vogël-Klinafc	19,547.00							Vazhd on
39	19-2025	Rindërtimi i rrugëve në qytet të Klinës me segmente të tyre: S. Rexhepi, F. Elezaj, M. Haxhaj, L. Palucaj, H. Prishtina, I. Qemajli, F. Bojaj	489,480.00	3000.00				2500.00		Vazhd on
40	32-2025	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore në Gjurgjevik të Madh-Dush	69,836.00	1111.00	150.00					Përfunduar
41	67-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Jashanicë-Jelloç-Resnik-Pograxhë dhe ndërtimi shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në Grykën e Jarinës-Pograxhë-Jashanicë	93,980.00	700.00						Vazhd on
42	005-2025	Punë shtesë- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në	9,410.00	82.00	230.00					Përfunduar

		Gjurgjevik të Madh								
43	06-2025	Punë shtesë në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë-Zabërgjë	7,966.50	112.00	118.00					Përfunduar
44	07-2025	Punë shtesë në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Sferkë-Volljakë-Qupevë”	23,035.82	666.00						Përfunduar
45		Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë-Zabërgjë, faza II	187,000.00	2850.00						Përfunduar
46	47-2025	Rindërtimi me asfalt i rrugëve në fshatin Sferkë, Komuna Klinë	239,000.00	2500.00						Përfunduar
47	46-2025	Rindërtimi me asfalt i rrugëve në Klinë-Shtupel-Binxhë-Grabç	339,000.00	3600.00						Përfunduar
48	54-2025	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore në	104,000.00	1600.00						Përfunduar

		Volljakë-Sferkë- Qupevë-Dush.								
49	53- 202 5	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë- rrugët “Martirët e Pastaselit”, “Martirët e Kralanit” etj.	139,471 .00	1200. 00	1200. 00					Përfun duar
50	48- 202 5	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Caravik-Çabiq- Dobërdol	67,944. 88	300.0 0						Vazhd on
51	49- 202 5	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore në Zllakuqan- Pataqan-Berkovë- Krushevë e Vogël (Trotuari Klinë- Zllakuqan)	109,844 .00	850.0 0	1200. 00					Përfun duar
52	59- 202 5	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina (Klinë-Burimi i Jarinës-Pograxhë- Ujmirë), si dhe rregullimi i shtratit të Lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bardhë	25,800. 00							Përfun duar
53	74- 202 5	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë- Jashanicë dhe	304,444 .44				1500 .00			Vazhd on

		Krushevë e Vogël-Zllakuqan								
54	75-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë	107,575.00	850.00	1050.00					Përfunduar
55	101-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gremnik-Qupevë	38,707.78		500.00					Vazhdon
56	96-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Përçevë dhe në rrugën "Shpella Azem Bejta" - Përçevë	428,982.00							Vazhdon
57	84-2025	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Pjetërq-Dugajevë-Drenoc	130,078.00	475.00						Vazhdon
		TOTAL	17,395,636.05	44,060.00	22,648.00	3,900.00	6,470.00	6,670.00	2,800.00	

Pra, gjatë periudhës së vitit 2025 janë realizuar këto punime:

- 30.96 km - rrugë të asfaltuara
- 9.10 km - rrugë të riasfaltuara
- 22,648.00 m - kanalizim fekal,
- 3,900.00 m - ujësjellës
- 6,470.00 m - trotuar
- 6,670.00m - ndriçim publik
- 2,800.00m - kanalizim atmosferik

Në total, në Komunën e Klinës janë realizuar:

- Rrugë të asfaltuara: 515.72 km
- Rrugë të riasfaltuara: 19.91 km
- Trotuare të ndërtuara: 39.495 km
- Shteg për biçikleta: 4.9 km

Gjatë kësaj periudhe, punëtorët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë marrë pjesë në komisione për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për projekte të ndryshme të Drejtorisë për Urbanizëm, si dhe të drejtorive të tjera, përfshirë edhe komisione të ndryshme profesionale. Janë mbajtur takime të shumta me donatorë dhe me dikastere të linjës, me qëllim të harmonizimit të punëve dhe përfitimit të projekteve të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe është hartuar plani i punës dhe plani i prokurimit për vitin 2026, janë përgatitur raportet mujore për punën e Drejtorisë, janë bërë vlerësimet dhe sistemimet e dosjeve për vitin përkatës, si dhe janë realizuar punë të tjera që lidhen me planifikimin, detyrat dhe aktivitetet e Drejtorisë.

Gjithashtu, është bërë shënimi i datave mjedisore, si: Dita e Tokës (22 prill), “Ta pastrojmë Kosovën” (24 maj) dhe Dita e Mjedisit (5 qershor). Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka realizuar edhe punë të tjera, si: inspektime në terren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe parallogari për rrugë, rrënim objektsh, mirëmbajtje të rrugëve, detyra projektuese, shqyrtim kërkesash, përgatitje projekt-propozimesh, raporte, mbikëqyrje të projekteve, pranime teknike, etj.

8.DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Fushëveprimtaria:

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtorja ka këtë fushëveprim:

- ✓ Vlerëson nevojat lokale shëndetësore;
- ✓ Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesin parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga MSh;
- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
- ✓ Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve si dhe Qendrës për Punë Sociale;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;
- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe të arriturve komunale në këtë fushë;
- ✓ Harton propozimet për lirimet nga pagesa për shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- ✓ Ndërmarrë veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesit parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të mjekësisë familjare, dhe përcjellja e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;
- ✓ Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuara në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor; kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ndërmerr masa parandaluese për zbulimin dhe diagnostikimin e hershëm, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- ✓ Organizon dhe zbaton procesin e imunizimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si një nga masat themelore të kujdesit ndaj shëndetit publik;

- ✓ Kujdeset për përparimin e shëndetit të fëmijëve, të rinjve dhe grupeve tjera;
- ✓ Promovon shëndetin oral dhe kujdesin themelor stomatologjik si dhe shëndetin mendor, në pajtim me metodat e avancuara;
- ✓ Kujdeset për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të qytetarëve të komunës, nëpërmjet aktiviteteve parandaluese (por duke mos u kufizuar vetëm në këto), si: promovimit të mënyrës së shëndoshë të jetesës, edukimit shëndetësor, ndërmarrjes së masave të përgjithshme kundër epidemike dhe preventive, si: dezinfektimi hapësinor, deratizimi dhe dezinfektimi, kontrollimi i mjedisit, kontrollimi i shkaktarëve, si dhe parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve, lëndimeve dhe gjendjeve me rëndësi sociale mjekësore;
- ✓ Zhvillon programe për aftësimin profesional të punëtorëve shëndetësorë nëpërmjet “Zhvillimit të vazhdueshëm profesional” (ZHVP), me qëllim të ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor;
- ✓ Bashkëpunon me kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- ✓ Vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;
- ✓ Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;
- ✓ Vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;
- ✓ Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit të komunës;
- ✓ Kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- ✓ Bashkëpunon me ministritë e përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera në nivelin lokal, përmes QPS – së;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturve komunale në këtë fushë;
- ✓ Përgatitë planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
- ✓ Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministritë e linjes;

QKMF / QMF / AMF – Raport i punës

Objektivi kryesor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare gjatë vitit 2025 ka qenë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rritja e numrit të shërbimeve mjekësore të ofruara në QKMF, është përmirësuar furnizimi me medikamente për pacientët, janë përmirësuar shërbimet e patronazhes, kujdesit paliativ, etj.

Furnizimet mjekësore /barna dhe pajisje mjekësore/ janë bërë me kohë dhe në sasi të mjaftueshme falë investimeve nga Komuna e Klinës si dhe nga Lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Qytetarët tanë kanë marrë shërbime cilësore në QKMF dhe janë furnizuar në masë të madhe me barna.

Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikë - Edhe në shërbimin e diagnostikës në QKMF janë kryer numër i madh i shërbimeve cilësore, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit dhe shërbimit të mamografisë, me aparatura moderne dhe pa kosto për shumicën e qytetarëve.

Gjatë vitit 2025 nuk kanë munguar edhe investimet kapitale në QKMF, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për qytetarët e komunës sonë. Janë krijuar hapësira të reja dhe është bërë renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore

Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore ka qenë prioritet edhe përgjatë vitit 2025. Është bërë trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante si dhe janë kryer procedurat e rekrutimeve për stafin mjekësor dhe teknikëve të infermierisë..

Ka vazhduar bashkëpunimi me donatorët ekzistues dhe janë zhvilluar takimet e reja me donatorët potencial ku janë prezantuar objektivat tona parësorë dhe projektet e planifikuara.

Vëmendje e madhe i është kushtuar programit për kujdesin mjekësor për të moshuarit, kujdesit paliativ dhe pacientëve terminal si dhe kujdesit mjekësor për komunitetet pakicë.

Është rritur angazhimi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët 0-3 vjeç si dhe gratë shtatzëna dhe lehonat, duke pasur mbështetje të vazhdueshme edhe nga programi i UNICEF-it. Është bërë ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk kanë mundur të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF

Organizimi i institucionit QKMF-së

Komuna e Klinës ka një **(1) Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF).**

Gjithsej numri i QKMF-ve që përmbushin kërkesat për inventar, mjete dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike është **një (1).**

Gjithsej numri i Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) është **tri (3):** Sferkë, Zllakuqan dhe Ujmirë.

Gjithsej numri i QMF-ve që përmbushin kërkesat për inventar, mjete dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike është **tri (3).**

Gjithsej numri i Ambulancave të Mjekësisë Familjare (AMF) është **dhjetë (10).**

Gjithsej numri i AMF-ve që përmbushin kërkesat për inventar dhe mjete është **dhjetë (10).**

Gjithsej numri i ekipeve të mjekësisë familjare 1 mjek specialist dhe 2 infermiere 1 mjek specialist dhe 2 infermierë 1 mjek specialist dhe 2 infermiere në QKMF është: **katërmëdhjetë (14) ekipe.**

Gjithsej numri i ekipeve të stomatologjisë 1 doktor i stomatologjisë dhe 1 teknik/asistent i doktorit të stomatologjisë dhe 1 teknik/asistent i doktorit të stomatologjisë dhe 1 teknik/asistent në QKMF është: **katër (4) ekipe.**

Shërbimet Shëndetësore të Kryera (Janar–Dhjetor 2025)

Mjekësia Familjare: 70,336 vizita
Emergjenca: 8,101 vizita
Stomatologjia: 2,392 vizita
Pediatria: 4,686 vizita
Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë (0–3 vjeç): 1,683 vizita
Vaksinimi: 3875
Laboratori: 14,782 pacientë
Rëntgeni (RTG): 4,631 raste
QMF dhe AMF në terren: 4,424 vizita
Shërbimet infermierike: 71,061 raste
Gjinekologjia, Pulmologjia, Radiologjia: 0 vizita (mungesë shërbimesh)
Klasa këshillimore për nëna dhe fëmijë: 166 raste
Kujdesi paliativ: 3,338 raste
Mamografia: 406 raste
Programi për Nena dhe fëmijë 0-3 vjeç: 985 vizita
Intervenca për fëmijë rekomandim i specialistit 1240 pacient
Totali i shërbimeve shëndetësore për vitin 2025: 191,537 raste

Projektet e reja

Hapja e dhomës për edukim dhe promovim shëndetësor (mbështetur nga UNICEF).
Trajnime për kujdesin në grup për prindërim.
Vizita sistematike në shkolla dhe vaksinim i nxënësve me mbulim deri në 97%.
Trajnime për stafin shëndetësor, karavane shëndetësore dhe aktivitete për ditët ndërkombëtare.
Rënovimi i shumicës së institucioneve shëndetësore (QKMF, QMF, AMF).
Ligjërata për drogat në shkollat fillore dhe të mesme.
Vendosja e gurthemelit për Urgjencën e re të qytetit dhe QMF 1.
Blerja e një autoambulance të re nga fondet e komunës.
Fushata për dhurimin e gjakut dhe vaksinimin kundër gripit sezonal.
Mbështetje nga KFOR-i italian për lavanderinë dhe furnizim me pajisje mjekësore.
EVP dhe ZHVP për infermiere dhe mjeke

Programi i Imunizimit

Fëmijë të planifikuar për imunizim: 3985
Fëmijë të imunizuar gjithsej: 3875
Regjistri i imunizimit (0–3 vjeç): 2135 fëmijë
Hepatiti B: 35 fëmijë
Nxënës të imunizuar (klasa I & VI): 1705

Shërbimet e Diagnostikës

Llojet e analizave laboratorike të ofruara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit raportues, në QKMF “Nënë Tereza” janë ofruar këto analiza laboratorike:

1. Sedimentimi i eritrociteve
2. Hemogrami (eritrocitet, hemoglobina, leukocitet, hematokriti, indeksat eritrocitare)
3. Formula leukocitare
4. Koha e koagulimit
5. Koha e gjakderdhjes
6. Analiza e përgjithshme e urinës
7. Glicemia
8. Urea
9. Kreatinina
10. Kolesterolitotal
11. Trigliceridet
12. Bilirubina totale
13. Bilirubina direkte
14. AST
15. ALT
16. Proteinat totale
17. Albumina
18. Natriumi (Na)
19. Kaliumi (K)
20. Kalciumi (Ca)
21. CRP (proteina reaktive C)
22. FT3
23. FT4
24. TSH
25. Hekuri në serum (Fe)
26. HbA1c (hemoglobina e glikoziluar)

Struktura në përqindje dhe numerike e analizave të realizuara (1 vit)

Kategoria e analizës, Përqindja, Pacientë (=) Totali i analizave

Analiza rutine komplet (biokimi, hemogram, sediment, urinë) 73.1 % 10,806 177,408

Hemogram 23.1 % 3,415 17,075

HbA1c 3.8 % 562 562

Proteina totale + albuminë 5.8 % 857 1,714

Hormonet tiroide (T3, T4, TSH) 11.5 % 1,700 5,100

Koha e koagulimit / gjakderdhjes 3.8 % 562 1,124

Elektrolite (Na⁺, K⁺, Ca) 5.8 % 857 2,571

Totali i përgjithshëm i analizave laboratorike të realizuara gjatë vitit 2025: ≈ 205,554 analiza laboratorike

Vlerësimi ekonomik i shërbimeve laboratorike (kursimi për qytetarët)

Kategoria, Numri i pacientëve, Çmimi për pacient, Totali (€)

Analiza rutine komplet 10,806; 25 €; 270,150 €

Vetëm hemogram 3,415; 5 €; 17,075 €

HbA1c 562; 10 €; 5,620 €

Proteina + albuminë 857; 5 €; 4,285 €

Hormonet tiroide 1,700; 15 €; 25,500 €
Koha e koagulimit/gjakderdhjes 562; 5 €; 2,810 €
Elektrolite 857; 5 €; 4,285 €
Kursimi real për qytetarët falë shërbimeve laboratorike publike në QKMF: 329,725 €
Numri total i pacientëve: 14,782
Totali i analizave laboratorike: ≈ 205,554 analiza
Kursimi ekonomik për qytetarët: ≈ 329,725 € (krahasuar me sektorin privat).

Shërbimet Radiologjike (Janar – Dhjetor 2025)

Radiografi (RTG): 4,631 pacientë (80% pa pagesë).
Mamografi: 406 raste, ofruar 100% falas për parandalimin e kancerit të gjirit.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale në bazë të fushë veprimtarisë së vet ka bërë përpjekje për kryerjen e misionit të saj në mënyrën më të mirë duke u mbështetur në detyrat dhe obligimet që i posedon në raport me ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët pa dallim. Po ashtu kujdes i veçantë i është kushtuar implementimit të politikave që janë nxjerrë nga niveli qeveritar në implementimin e standardeve për mbrojtën e kategorive të ndryshme sociale që kanë nevojë për këto shërbime.

Në kuadër të misionit të QPS-së, tretman i veçantë i është kushtuar kategorive më të rrezikuara dhe që kanë nevojë për shërbimet që ju ofron ky institucion në veçanti për: Fëmijët e braktisur, fëmijët pa kujdes prindëror, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, personat e moshuar dhe pa përkujdesje, personat më nevojë të veçanta, delikuentet etj.

Mision tjetër i QPS-së ka qenë edhe ofrimi i ndihmës financiare nëpërmjet sektorit të Asistencës Sociale për familjet nevojtare të cilat i plotësojnë kriteret që janë të parapara në Ligjin dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, gjithmonë duke u bazuar edhe në verifikimin dhe monitorimin e këtyre familjeve nevojtare.

Fusha e trajnimit

Gjatë vitit 2025, stafi i Qendrës Për Punë Sociale, ka marrë pjesë në disa trajnime kryesisht të fushës sociale, ku edhe janë certifikuar, certifikata këto të nevojshme për ri licencim të zyrtarëve që ofrojnë shërbime sociale.

Bashkëpunimi me Organizatat jo qeveritare

Kur jemi të bashkëpunimi me Organizatat Jo Qeveritare, ne si Institucion kemi pasur një bashkëpunim mjaft të mirë më të gjitha ato Organizata që për mision kanë mirëqenien e qytetarëve, andaj unë do ti veçoja disa nga këto:

- OJQ "Arbeiter Samariter Bund- ASB" me seli në Prizren ku është realizuar suksesshëm projekti "Mbështetje e Integruar Socio ekonomike për familjet e prekura pakicë dhe shumicë në Klinë".

- Caritas Umbria - e cila çdo herë na përgjigjet në kërkesat tona për ndihmë familjeve skamnore;
- Qendra për Mirëqenien e Gruas - Shtëpia e Sigurt në Pejë, ku kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë, ku çdo herë na janë përgjigjur pozitivisht në kërkesat tona për strehimin e viktimave të dhunës në familje, duke respektuar kështu memorandum bashkëpunimit të kësaj Organizate me Komunën e Klinës.
- Terre des hommes, Organizatë kjo që përpos trajnimeve të organizuara, herë pas here na ka ndihmuar në ofrimin e ndihmës direkte (veshmbathje, pajisje shkollore, medikamente mjekësore) për disa familje.
- Shoqata Humanitare Bamirëse “Dushkaja”, me seli në Gjakovë, ku janë ndihmuar shumë familje skamnore me veshmbathje të përdorura, të ardhura nga Gjermania.
- UNICEF - United National International Children’s Emergency Fund (Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet).
- OFAP - Organizata për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror
- GIZ – Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Save the Children në Kosovë, pastaj bashkëpunim të mire kemi pasur edhe me OSBE, Syri Vision - Organizatë që realizon veprime lokale të bazuara në praktikën më të mirë me seli në Pejë, etj.

Pjesa kryesore

Raporti është përpiluar i ndarë sipas sektorëve që funksionojnë në kuadër të QPS-së, atë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe Sektorin e Asistencës Sociale.

Sektori i Shërbimeve Sociale

Sektori i Shërbimeve Sociale gjatë vitit 2025, ka kryer shërbime të ndryshme në përkrahje të familjeve dhe personave në nevojë sociale, në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri të përkrahja për familjet me probleme sociale, kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve, kujdesi dhe mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa tjera).

Bashkëpunimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale me Institucione si, Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, institucionet shkollore, zyrën për ndihmë juridike falas, si dhe me OJQ të ndryshme ka qenë në nivelin më të mirë të mundshëm.

Gjatë vitit 2025, Shërbimi Social ka realizuar vizita në familje të cilat kanë fëmijë me nevojë të veçanta, fëmijë në strehim familjar, fëmijë nën kujdestari, ka marr pjesë në intervistimin e të miturve në polici, ka marr pjesë në seanca gjyqësore, si dhe ka realizuar vizita tjera në familje të ndryshme ku është paraqitur nevoja e ofrimit të shërbimeve sociale.

Me poshtë e keni raportin e sektorit të Shërbimeve Sociale në formë tabelore

Nr.	Shërbimet e kryera	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve aktive (ekzistuese)	Vërejtje
1	Fëmijë jetim	1	1	
2	Fëmijë të braktisur	3	17	
3	Kujdestari për fëmijë	4	18	
4	Mbikëqyrje e shtuar nga Organi i Kujdestarisë për fëmijë	3	3	
5	Kujdestari për raste të veçanta	4	13	
6	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	6	6	
7	Adoptime – Periudhë provuese për Adoptim	0	/	
8	Dhunë në familje	38	38	
9	Strehim familjar tek të afërmit/nr. fëmijëve	4	11	
10	Strehim familjar jashtëfarëfisit / nr. fëmijëve	2	2	
11	Strehim në shtëpinë e sigurt në Pejë	5	/	
12	Vendosje të fëmijëve në SOS fshatin e fëmijëve në Prishtinë	0	1	
13	Strehim i personave madhorë në Institutin e Special në Shtime dhe Deçan	0	6	
14	Strehim i fëmijëve në shoqatën “Caritas Umbria”, në Leskoc	0	1	
15	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	50	/	
16	Përcjellje të kontaktit fëmijë-prind	15	6	
17	Shkurorëzime	17	0	
18	Fëmijë nga prindërit e shkurorëzuar	25	0	
19	Strehim i të moshuarve në shtëpinë për të moshuar në Gurakoc dhe Skenderaj	1	6	
20	Vërtetime dhe deklarata	621	/	
21	Kërkesa për mbështetje financiare familjes për fëmijë më nevoja të veçanta	11	88	
22	Pjesëmarrje në seanca gjyqësore	17	/	
23	Kujdestari për përfaqësime në seanca gjyqësore	7	/	
24	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të së drejtës prindërore	0	/	
25	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të zotësisë së veprimit	/	/	
26	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për shërim të detyrueshëm	1	/	
27	Kërkesa, raporte, Gjykatë, polici, QKMF, Shëndeti mendor në Pejë, konstatime zyrtare, pëlqime etj	39	/	
28	Regjistrime të fëmijëve në Zyrën e gjendjes civile	/	/	
29	Lindje jashtëmartesore	/	/	
30	Anamneza sociale	11	/	
31	Konstatime zyrtare për bashkim familjarë	17	/	

Sektori i Asistencës Sociale

Në periudhën që po raportojmë, numri i familjeve shfrytëzuese të Ndhmës Sociale në të dy kategoritë është 709.

Gjithashtu, gjatë periudhës që po raportojmë në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Organizata humanitare, biznese të ndryshme, Organizata jo Qeveritare etj, i kemi ndihmuar disa familje nevojtare me pako të ndryshme (higjienike, ushqimore, veshmbathje).

Me poshtë e keni raportin e sektorit të Asistencës Sociale në mënyrë tabelore për periudhën raportuese:

Aktivitetet	Kategoria I dhe II
Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë	62
Sa prej tyre janë të aprovuara	46
Sa prej tyre janë të refuzuara	9
Sa janë në shqyrtim	7
Numri i rasteve të ndërprera	15
Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e As. sociale	2
Numri i ankesave të aprovuara	1
Numri i ankesave të refuzuara	1
Nr. ankesave në shqyrtim	0

Realizimi i te hyrave nga tarifat administrative në Qendrës për Punë Sociale

Bazuar në Rregulloren mbi Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, në Institucionin e QPS-së, tariforen disa nga vërtetimet që i lëshon ky Institucion. Gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, kemi arritur që të grumbullojmë një shumë të konsiderueshme të të hollave, të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës së Klinës. Në vazhdim në mënyrë të detajizuar i keni të hyrat që janë grumbulluar për periudhën Janar – Dhjetor 2025:

Muaji	Përshkrimi	Nr. & tarifa adm.	Shuma totale - Euro
Janar - Dhjetor 2025	Vërtetim që nuk i është marr ose kufizuar aftësia për te vepruar (për marrjen e lejes për armëmbajtje)	351 x 20 €	7,020.00 €
Janar - Dhjetor 2025	Vërtetim për lirim / fitim nga shtetësia e Kosovës	188 x 10 €	1,880.00 €
Janar - Dhjetor 2025	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i Asistencës Sociale	42 x 2 €	84.00 €
Janar - Dhjetor 2025	Anamnezë sociale	9 x 5 €	40.00 €
			Totali: 9,024.00€

Sfidat

- Rritja e buxhetit të Qendrës për Punë Sociale, tek kategoria e shpenzimeve -mallra dhe shërbime.
- Sigurimi i një veture për nevojat e Institucionit, pasi që me një veturë të vetme nuk po ia arrijmë t'i kryejmë të gjitha shërbimet në terren.

Përfundimi

Qendra për Punë Sociale, kujdeset për banorët e Komunës sonë në nevojë për shërbime sociale dhe ndihmë financiare, pa dallim. Shuma e të hollave që shpërndahen përmes këtij Institucioni brenda një viti kalendarik është mbi 1.4 milion Euro, duke përfshi këtu familjet përfituese të Asistencës Sociale, familjet që kanë fëmijë më nevoja të veçanta si dhe familjet që kanë në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare.

Konsiderojmë se, edhe për kundër disa sfidave, periudhën që po raportojmë e kemi përmbyll suksesshëm, krejt kjo falë punës së stafit të QPS-së, me punën dhe angazhimin e të cilëve është bërë realizimi i planit dhe detyrave të punës, gjithashtu falë edhe bashkëpunimit të mirë me DSHMS-në, DPSF-në, si dhe me Institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare.

Mbesim me shpresë që angazhimi dhe bashkëpunimi në vitin e ardhshëm do rritet, në mënyrë që të arrihet në plotësi realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave për vitin 2026.

9. DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente gjatë këtij viti ka qenë e preokupuar me realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Gjatë periudhës vjetore 2025, në sektorin e shërbimeve publike, nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej **363 kërkesa**, të cilat kanë të bëjnë me:

- ☐ riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe rrugica në lagjet e qytetit,
- ☐ riparimin e gropave në rrugët me asfalt,
- ☐ furnizimin me ujë dhe riparimin e ujësjellësit,
- ☐ riparimin dhe kyçjen në kanalizim,
- ☐ lëshimin e lejeve për shfrytëzim të hapësirës publike,
- ☐ ndriçimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik,
- ☐ pastrimin e rrugëve nga bora,
- ☐ kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimorë dhe material ndërtimor për ndërtim apo renovim të shtëpive.

Varësisht nga mundësitë buxhetore, drejtorja u është përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Gjendja e shqyrtimit të kërkesave është si në vijim:

Përshkrimi	Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01.01.2025 – 01.01.2026, Drejtoria: D.SH.P.E
Pranuar	2
Në Proces	0
Miraturar	287
Refuzuar	57
Hedhur Poshtë	7
Pezulluar	5
Ceduar	0
Anuluar	5
GJITHSEJ	363

Ndërsa sa ju përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për këtë vit, shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2025:

- **Trajtimi i qenve endacakë.**

Qentë endacakë janë problem në gjithë Kosovën, ndërsa Komuna e Klinës është ndër komunitetet e pakta të Kosovës që ka lidhur kontratë për trajtimin e qenve endacakë. Drejtoria e Shërbimeve Publike Emergjente ka lidhur kontratë në vlerë prej 30,000 €, në kuadër të së cilës janë trajtuar, sterilizuar, shëruar, larguar dhe ushqyer qentë endacakë. Është bërë kastrimi i tyre dhe janë mbajtur, ushqyer dhe mbikëqyrur deri në shërimin e plotë, pastaj janë lëshuar përsëri në vendin ku janë kapur dhe është eliminuar rreziku që paraqisnin. Kjo ka rezultuar si një sukses nga ana jonë, pasi janë eliminuar shumë rreziqe për qytetarët.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i kamerave të qytetit.**

Është bërë zgjerimi i rrjetit të kamerave dhe vendosja e tyre në vende të reja. Te salla “Adem Jashari” janë vendosur 5 kamera, si dhe njëkohësisht është bërë mirëmbajtja e kamerave ekzistuese. Kontrata është lidhur më 18.04.2024 dhe është në vlerë prej 15,000 €.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik.**

Gjatë këtij viti, në kuadër të kësaj kontrate kemi punuar në shumë fshatra në mirëmbajtjen e ndriçimit publik, si p.sh.: Zllakuqan, Volljakë, Rudicë, Ujmirë, Rixhevë, Gllarevë, Jagodë, Budisalc, Grabanicë, Gjurgjevik i Vogël, Deiq, Zajm, si dhe në Klinë dhe lagjet përreth qytetit. Kjo kontratë ka përfunduar në gusht të vitit 2024. Kontrata e re për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Komunën e Klinës është lidhur më 27.09.2024 dhe është kontratë dyvjeçare.

- **Shtrimi i rrugëve fushore.**

Po ashtu, kemi vazhduar me shtrimin e rrugëve me zhavorr. Operatori ekonomik ka punuar në fshatin Gllarevë; në Jashanicë te lagjja e Hotëve dhe te varrezat; në Jashanicë te lagjja e Shpatëve dhe varrezat e Kuqve; në Jashanicë te lagjja Haziraj dhe Isenaj; në Resnik te rruga e Arave, si dhe te rruga e varrezave të fshatit dhe varrezat e dëshmorëve; në Pjetërq, Gjurgjevik i Vogël, Rixhevë te varrezat e fshatit, Shtupel, Çabiq, Grabanicë, Zllakuqan, Krushevë e Madhe në rrugë fushore, si dhe te lagjet me komunitete në Gremnik, Dollovë, Qeskovë dhe në fshatra të tjerë. Kjo kontratë ka përfunduar në fund të vitit 2024.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit.**

Qyteti i Klinës ishte qyteti më i dekoruar në krahasim me qytetet e tjera. Patëm numër të madh të qytetarëve që vinin edhe nga qytete të tjera, posaçërisht nga qytetet fqinje, për t’u kënaqur me atmosferën e krijuar për më shumë se një muaj rresht. Ka qenë kontratë trevjeçare dhe ka përfunduar në këtë vit.

- **Mirëmbajtja e stacionit të autobusëve në Klinë. Shërbime dhe siguri në stacionin e autobusëve të Klinës.**

Komuna e Klinës ka lidhur kontratë me qëllim që të sigurohet mirëmbajtja dhe siguria në stacionin e autobusëve të Klinës. Kompania ka angazhuar punëtorë të cilët kanë kryer mirëmbajtjen e objektit dhe stacionit në tërësi, duke u përkujdesur për rampën, peronat dhe linjat e autobusëve, sipas detyrave të përcaktuara në kontratë.

- **Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik në Krushevë të vogël, Drenoc, Qeskovë, Jashanicë, Leskoc, Ranoc.**

Komuna ka investuar **206,550 €**, ku është lidhur kontrata më 08.05.2024. Është intervenuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, duke e shtrirë ndriçimin në fshatra dhe pjesë ku më herët nuk kishte ndriçim. Zgjerimi është realizuar në fshatrat: Dush, Sferkë, Qupevë, Pjetërq, Çabiq, Zabërgjë, Përçevë, Radulloc, Zajm, Qeskovë, Bokshiq, Këpuz dhe Krushevë e Madhe, ndërsa do të vazhdojë në vitin 2025 në fshatrat Krushevë e Vogël, Drenoc, Leskoc, etj.

Komuna ka lidhur kontratë me titull: **“Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (parqeve) në Zajm, Caravik, Pjetërq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc”**, të lidhur nga Komuna e Klinës më datë 12.06.2024, me nr. bazë 55-2024, nr. protokolli 01/352-18993/24, nr. prokurimi 634-24-4343-5-2-1, me vlerë 36,150.00 € dhe me plan dinamik 30 ditë.

Kontrata në fjalë është ekzekutuar në fshatin Caravik dhe përfshin hapësira rekreative për fëmijë, restaurimin e kroit të vjetër të fshatit, shtigje ecjeje, ulëse, ndriçim të parkut dhe ndriçimin e rrugës kryesore nga parku deri te shkolla fillore, si dhe gjelbërim të ulët dhe të lartë. Kontrata është përfunduar.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Emergjente ka iniciuar edhe kontratë me titull: **“Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (parqeve) në Zajm, Caravik, Pjetërq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc”**, e lidhur nga Komuna e Klinës më datë 10.06.2024, me nr. bazë 54-2024, nr. protokolli 01/352-18730/24, nr. prokurimi 634-24-4352-5-2-1, me vlerë 27,799.19 € dhe me plan dinamik 30 ditë.

Kontrata në fjalë është ekzekutuar në fshatin Zajm dhe përfshin shtigje ecjeje, gjelbërim të ulët dhe të lartë, ulëse dhe ndriçim, si dhe rregullimin e kanalit për ujërat atmosferikë. Kontrata është përfunduar.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Emergjente ka kontratë me titull: **“Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë–Shtupel–Resnik–Klinë–Videjë”**, e lidhur nga Komuna e Klinës më datë 26.03.2024, me nr. bazë 22-2024, nr. protokolli 01/351/9907/24, me vlerë 224,475.00 €. Punimet janë zhvilluar në fshatrat: Shtupel, Jashanicë dhe Klinë, kryesisht në sanimin e asfaltit, rikonstruimin e kubëzave, vendosjen e gypave dhe kapakëve të pusetave. Kontrata është në realizim.

Komuna e Klinës ka lidhur gjithashtu kontratë me titull: **“Ndërtimi i rrethojave të varrezave në Zajm, Dobërdol, Sferkë, Gllarevë, Ujmirë”**, e lidhur më datë 16.06.2024, me nr. bazë 57-2024, nr. protokolli 01/351-18933/24, nr. prokurimi 634-24-4242-5-2-1, me vlerë 129,940.00 € dhe me plan dinamik 12 muaj. Deri më tani janë realizuar punime në fshatrat Dobërdol dhe Ujmirë. Kontrata është në realizim.

Mirëmbajtja e drunjve dekorativ.

Në qytet kemi rreth **200** trupa të drunjve dekorativë, duke filluar nga Sheshi “Ndue Përlleshi”, Sheshi “Mujë Krasniqi”, Sheshi “Nënë Tereza” e deri te Sheshi “Faruk Elezaj”. Duke qenë se për tre vite rresht kjo pjesë e qytetit ishte në ndërtim, për shkak të punimeve të tunelit dhe kalldrëmit, drunjtë kishin pësuar dëmtime të mëdha. Prandaj, ka qenë e domosdoshme që në mënyrë profesionale të trajtohen të gjithë këta drunj, duke filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimi i tokës përreth, etj. Tani pemët kanë marrë formë të mirë dhe të njëtrajtshme, kanë rritje të mirë dhe janë të shëndetshme. Vlera e kontratës është 12,972.00 €, ndërsa kontrata është trevjeçare.

- **Marrëveshje me Fondin për Energji Eficiente FKEE për shtimin e masave eficiente.**

Drejtorja e Shërbimeve Publike ka aplikuar dhe ka arritur një marrëveshje të rëndësishme ndërmjet Komunës së Klinës dhe Fondit për Energji Eficiente (FKEE), përmes së cilës është siguruar një investim prej 648,000 €. Ky investim ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e disa banesave përfituese në qytetin e Klinës, përmes shtimit të masave për energji eficiente, ndërsa Komuna do të bashkëfinancojë vetëm 10 % të vlerës totale.

Ky investim do të mundësojë rritjen e cilësisë së jetesës për qytetarët, duke u dhënë mundësinë të përfitojnë dhe të kursejnë shpenzimet mujore për energjinë elektrike dhe ngrohjen. Në kuadër të projektit do të bëhet ndërrimi i dritareve dhe dyerve, izolimi me 12 cm stiropor, rregullimi i kulmit me të gjitha pjesët përbërëse, si dhe montimi i një inverteri për ftohje-ngrohje të hapësirës, përveç disa punëve të tjera përcjellëse.

Për më tepër, ky projekt është në përputhje me angazhimet për mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e emetimeve të gazrave serrë, duke pasur një ndikim pozitiv në klimë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Klinës.

Drejtorja e Shërbimeve Publike është koordinatore e projektit dhe po vazhdon të punojë në mënyrë aktive për realizimin e tij, duke siguruar mbështetje për qytetarët e përfshirë dhe duke i udhëzuar ata për shfrytëzimin e plotë të mundësive që ofron ky investim. Po ashtu, drejtorja ka aplikuar edhe për ndërtesa të tjera në Fondin për Energji Eficiente dhe është në pritje të përgjigjeve, ku janë përfshirë mbi 20 ndërtesa të tjera publiko-kolektive.

- **Furnizim me pajise dhe mjete pune për zjarrfikësit.**

Edhe këtë vit, Drejtorja e Shërbimeve Publike Emergjente ka investuar në furnizimin me mjete për ndërhyrje të zjarrfikësve, duke u pajisur me një hidrant, dy fiskaja, një fshesë për mirëmbajtje, një vinç-kran për tërheqje të montuar në kamion, si dhe maska kundër tymit.

- **Furnizim me uniforma për zjarrfikës.**

Drejtorja e Shërbimeve Publike Emergjente ka realizuar gjithashtu furnizimin e zjarrfikësve me uniforma të reja, duke marrë parasysh angazhimin dhe rrezikshmërinë e punës së tyre. Me këtë furnizim janë zëvendësuar uniformat e vjetra, të cilat gjatë punës në terren kishin pësuar dëmtime.

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza Zllakuqan-Jashanicë-Gllarevë.

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Gllarevë, projekt shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm, ka përfunduar. Ky projekt ka qenë një nga premtimet e kryetarit Elezaj, ndërsa vlera e kontratës është 245,996.00 €.

- **Mirëmbajtja e hapësirave publike, parqeve dhe trotuareve.**

Komuna e Klinës ka lidhur marrëveshje më datë 22.02.2024 për kryerjen e shërbimeve të kërkuara sipas kontratës, përfshirë pastrimin e shesheve dhe hapësirave gjelbëruese, me kompaninë KRM “Ambienti”, Njësia Operative në Klinë. Kompania ka kryer me sukses shërbimet e kërkuara nga Komuna e Klinës, duke përmbushur obligimet e dhëna, ndërsa kontrata është trevjeçare.

- **Njësia e Zjarrfikësve në Klinë**

Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH) në Klinë, gjatë kësaj periudhe kohore, aktivitetin e vet e ka bazuar në planin e punës për vitin 2024 dhe, si zakonisht, ka arritur t'i përmbushë me sukses objektivat e parapara me plan. NJPZSH në Klinë ka vazhduar të mbajë nivel të lartë të gatishmërisë për reagim në rast nevojë, si dhe për raste emergjente, gjatë periudhës së lartcekur.

Ne jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrës që na obligojnë ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës.

NJPZSH në Klinë i është përgjigjur të gjitha thirrjeve për raste emergjente, në përputhje me obligimet dhe kapacitetet tona ekzistuese. Gjithashtu, jemi përgjigjur me kohë ndaj qytetarëve të dëmtuar dhe kemi lëshuar vërtetime për zjarret (dëmet) e ndodhura.

Në NJPZSH në Klinë, disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës janë në nivel të kënaqshëm. Ndërrimet janë kryer sipas orarit të paraparë dhe niveli i gatishmërisë ka qenë, si zakonisht, i lartë për t'u përgjigjur kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të komunës sonë dhe më gjerë, sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuese.

Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH-së gjatë periudhës janar–dhjetor 2024 janë paraqitur në tabelën që vijon:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve të tjera janar-dhjetor 2024:														
2024	Nr.i përgj. i daljeve	Nr. i zjarreve	Nr. Teknik	Nr.i shërbi meve	Aksid ente rrugore	Vërsh ime	Të realizuara	Të lënduar			Të vdekur			Gjith se
Janar	7	6	0	0	1	0	0	0	2	0	0	1	1	7
Shku rt	39	38	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	39
Mars	24	21	1	1	1	0	0	0	2	2	0	1	0	24
Prill	19	15	3	1	0	0	0	0	5	5	0	0	0	19
Maj	6	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
Qers hor	7	5	1	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	7
Korri k	39	31	5	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	39
Gush t	69	61	5	2	1	0	0	0	1	0	1	0	0	69
Shtat or	29	24	2	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	29
Tetor	12	9	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12
Nënt or	7	5	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Dhje tor														0
Gjith se														258

10. DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

Gjatë vitit 2025 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, udhëzimet administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që dalin nga to, si dhe bazuar në Planin e Punës të aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2025, siç vijon:

Sektori për Financa

- Gjatë vitit **2025**, në Zyrën e Bizneseve janë regjistruar gjithsej **139** biznese të reja: **29** biznese individuale dhe **110** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa janë shuar **25** biznese.
- Gjithashtu, janë lëshuar **73** licenca për taksë, **21** aktvendime për linja me itinerar të autobusëve dhe **1** aktvendim për zgjatje të orarit të punës për biznese.
- Janë lëshuar mbi **75** akte administrativo-juridike që ndërlidhen me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
- Janë lëshuar **18** certifikata të gjendjes ekonomike.
- Janë certifikuar të gjitha pagesat për mallra, shërbime dhe punë.
- Janë lëshuar **28** aktvendime për shfrytëzimin e hapësirës komunale.
- Janë lëshuar **13** vërtetime për pension.
- Janë lëshuar **28** vendime pas shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave.
- Janë bërë të gjitha zotimet për shpenzimet e realizuara gjatë vitit.
- Janë realizuar pagesa për taksa komunale për vetura dhe automjete të rënda.
- Është bërë regjistrimi i rregullt i të hyrave vetanake të paguara përmes arkës dhe bankës.
- Është bërë regjistrimi i pasurisë komunale në sistemin FreeBalance.
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave me Departamentin e Thesarit në baza mujore.
- Janë dërguar kërkesa për alokim të të hyrave sipas realizimit dhe buxhetit të planifikuar.

Sektori për Buxhet

Janë përgatitur dhe lëshuar **1,882 aktvendime** të ngarkesës me taksë për licenca të subjekteve afariste që operojnë në Komunën e Klinës për vitin 2025, të cilat u janë dorëzuar të gjithë obliguesve tatimorë brenda afatit të paraparë ligjor.

Në këtë sektor, problem kyç mbetet mosregjistrimi i disa subjekteve afariste që operojnë ilegalisht në komunën tonë, si dhe i atyre që i kanë mbyllur subjektet afariste, por nuk i janë nënshtruar procedurave ligjore të çregjistrimit. Këto raste paraqesin problem serioz gjatë ngarkesave vjetore për subjektet që nuk kanë sjellë dëshmi për ndërprerjen e veprimtarisë, respektivisht për mosaktivitetin afarist, por kjo çështje trajtohet në koordinim me organet e tjera relevante kompetente, si Inspektorati Komunal etj.

- Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2024
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për të gjitha programet

- Janë përgatitur pasqyrat financiare për vitin 2025
- Janë përgatitur raporte financiare periodike gjatë vitit
- Është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2026
- Janë përgatitur shkresa për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me transferet brenda programeve dhe kërkesat e ndryshme për realizimin e projekteve
- Është bërë evidencimi sipas programeve dhe kodeve ekonomike në Excel
- Është bërë barazimi i rregullt i shpenzimeve me MF-në në baza tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore
- Janë kryer shërbime të tjera zyrtare sipas kërkesave

Sektori i tatimit në pronë

Sektori i Tatimit në Pronë, gjatë periudhës **janar–dhjetor 2025**, ka kryer këto punë:

Vlera totale e tatimit të faturuar për vitin 2025 për objekte dhe parcela është **1,036,310.13 €**.

Vlera totale e interesit për vitin 2025 është **11,645.61 €**.

Vlera totale e penaltetit (kamatës) për vitin 2025 është **81,020.89 €**.

Gjatë kësaj periudhe të vitit fiskal **janar-dhjetor 2025**, nga Zyra e Tatimit në Pronë (ZTP) janë inkasuar gjithsej **586,707.52 €**, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 janë inkasuar më shumë **35,708.08 €**. Nëse krahasojmë tatimin e faturuar me tatimin e inkasuar për vitin 2025, rezulton se janë inkasuar afërsisht **56.61%** e tatimit të faturuar.

Gjatë vitit 2025, kjo zyrë ka kryer edhe shumë punë të tjera, si: lëshimi i certifikatave dhe lëshimi i faturave apo kartelave financiare për qytetarë, për persona fizikë dhe juridikë. Po ashtu, gjatë vitit 2025 është bërë verifikimi i pronave në terren nga anketuesi, ku janë verifikuar kryesisht zona e parë, e dytë dhe e tretë.

Ankesat për tatimin në pronë

Të gjitha ankesat e vitit 2025 janë shqyrtuar. Zyra e Tatimit në Pronë ka pranuar gjithsej **24 ankesa** të natyrave të ndryshme, prej të cilave **18 janë aprovuar, 5 janë refuzuar**, ndërsa **1 është tërhequr**.

Zyra e Tatimit në Pronë, gjatë vitit 2025, ka verifikuar edhe tatimpaguesit me borxhe mbi shumën **300 €** dhe ka marrë vendime përkatëse. Më poshtë paraqitet tabela me vlerat e tyre:

	Viti 2025		
	2025	Janar-Dhjetor 2025	
Masat e mbledhjes së detyruar të ndërmarra nga komunat			0
Letërkujtesa	309		309
Kontrata për pagesë me këste	5		5

Si brengë e paraqitur gjatë këtij viti, vlen të përmendet se te tatimi në pronë për objekte ka pasur zbritje, si dhe është ngarkuar tatimi për toka bujqësore, ku qytetarët kanë paguar më pak, për shkak se shumica e tyre nuk i kanë pronat të regjistruara në emër të tyre. Po ashtu, disa ndërmarrje që janë privatizuar dhe të tjera që janë në proces të privatizimit paraqesin vështirësi, pasi në bashkëpunim me MEF-in nuk kemi qasje të duhur për inkasimin e mjeteve financiare nga tatimi në pronë për objekte të privatizuara apo në proces privatizimi, për shkak se organi kompetent i privatizimit nuk e detajon dhe nuk e precizon qartë se cili obligues mbetet përgjegjës për kryerjen e këtyre obligimeve tatimore.

Risi tjetër në tatimin në pronë janë edhe ngarkesat për **shfrytëzuesit faktikë**, të cilët nuk janë pronarë juridikë të pronave. Kjo situatë paraqitet kryesisht në rastet e pronarëve të nacionalitetit joshqiptar, pronat e të cilëve shfrytëzohen nga shfrytëzues të tjerë që tentojnë t'u shmangen obligimeve tatimore.

Një rast tjetër që paraqet pengesë në këtë drejtim është fakti se **kamata e përcaktuar sipas ligjit** nuk merret përsipër nga obliguesi faktik apo juridik i pronarit legjitim, qoftë ai person fizik apo juridik.

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën

janar – dhjetor 2025

Për të analizuar realizimin e buxhetit për vitin fiskal 2025, paraqitet një pasqyrë e buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Po ashtu, janë analizuar disa trende të këtyre kategorive buxhetore dhe janë bërë krahasime me parametrat buxhetorë të vitit paraprak, siç paraqiten në **Shtojcën – Raporti Financiar për vitin 2025**, e cila i bashkëngjitet këtij raport.

Në Zyrën e Thesarit është tejkaluar planifikimi i realizimit të pagesave të certifikuara gjatë vitit 2025 sipas buxhetit të aprovuar, në vlerë prej **16,168,653.00 €**. Ndikim në këtë tejkalim ka pasur rritja e buxhetit nga të hyrat vetanake të bartura nga viti 2024, nga Granti i Performancës dhe nga Grantet e Donatorëve të Brendshëm.

Sa i përket çështjes së pagesave të Zyrës së Thesarit, vlerësojmë se gjatë këtij viti ato janë realizuar në përputhshmëri me Planin Kontabël dhe brenda afateve të përcaktuara sipas legjislacionit aplikativ.

Gjatë vitit 2025, vlen të theksohet se realizimi i të hyrave vetanake ka qenë në përputhje me planifikimin, si dhe ka pasur tejkalim në shumën prej **556,697.80 €**. Shpenzimi i buxhetit, si në projekte kapitale ashtu edhe në kategoritë e tjera buxhetore, është realizuar sipas planifikimit.

Pagesat e proceduara gjatë vitit 2025 janë gjithsej **3,473 transaksione**, prej të cilave:

- Brenda afatit ligjor prej 30 ditësh janë proceduar **3,406 pagesa të faturave**;
- Jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh janë proceduar **67 pagesa të faturave**, kryesisht fatura të shpenzimeve komunale (borxhe të grumbulluara për shkak të mungesës së buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunale).
- Buxheti total i shpenzuar për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë, subvencionimin në bujqësi dhe zhvillim ekonomik, subvencionimin e transportit të nxënësve të arsimit fillor, bursat për studentë dhe skema të tjera të subvencionimit (lindje, trajtim mjekësor dhe shpenzime varrimi) gjatë vitit 2025 është **740,623.14 €**.
- Buxheti i shpenzuar për këto skema për **gra dhe vajza** është **216,027.51 €**.
- Numri i përgjithshëm i përfituesve është **2,433**.
- Numri i grave përfituese është **983**.

– Buxheti total i shpenzuar për paga, shtesa dhe kompensime gjatë vitit 2025 është **9,044,041.26 €**, nga kjo shumë, shpenzimi për paga, shtesa dhe kompensime për **gra dhe vajza** është afërsisht **4,416,702.36 €**.

– Numri i të punësuarve me norma të plota dhe jo të plota gjatë vitit 2025 është **1046**, prej të cilëve **474** janë gra dhe vajza.

Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2024

Numri i përgjithshëm i rekomandimeve për vitin 2024 ka qenë **8 rekomandime**, prej të cilave:

- **1 rekomandim** është zbatuar;
- **7 rekomandime** janë në proces të zbatimit brenda afatit sipas planit të veprimit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 ka qenë sfidë e madhe borxhi ndaj punëtorëve të arsimit si pasojë e kontratës kolektive të arsimit. Komuna e Klinës gjatë vitit 2025 vendime gjyqësore ka paguar shumën prej 609,160.27 €.

Ka edhe shumë çështje të tjera që do të duhej të theksoheshin, por në tërësi vlerësojmë se ky vit kalendarik ka qenë një vit i realizimit të plotë të objektivave të planifikuara, dhe në disa raste edhe i tejkalimit të tyre. Me këtë raport jemi përpjekur që në pikat kryesore të

përfshijmë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit aplikativ në fuqi, me synimin që në të ardhmen këto obligime t'i rrisim si në aspektin cilësor, ashtu edhe në atë sasior.

Kryetari i Komunës

z. Zenun Elezaj

